

Një burrë i qeshur, interesant, shprehës dhe herë-herë hokatar, njeri që s'bie kurrë në dëshpërim, të cilit vetëm i hanë duart për punë, njeri me humor të mirë, gjithnjë i shkujdesur dhe plot batuta të thukëta...

ROLAND DASHO, Skënderbeu i vogël i filmit

Intervistoi: Xhevair Lleshi



(fq. 2)

KRISTO FLOQI, KOHA DHE VEPRA E TIJ LETRARE

Prof. As. Dr. JONELA SPAHO

Detyra që qëndron para kujdo kur i hyn punës për të shkruar për një autor a çështje të caktuar, është të japë një sintezë të asaj që është arritur në këtë fushë studimi, për të kuptuar se në çdrejtime do ta shpjerë më përpara ai mendimin shkencor në fushën përkatëse...

(fq. 12)

HERMETIZMI SI ALTRUIZËM I KUPTIMIT NË POEZINË E MARTIN CAMAJT

Yzedin Hima

Camaj e ka kaluar fëmijërinë në viset epike të arbërisë, në Alpe. Imazhet e këtyre viseve herë – herë shfaqen befasuese në tekstet poetike, së bashku me fjalët curraj, karpa, korbi, gjethue, mjedërr, xhingalla, xhixhillojë, qokth etj.

(fq. 5)

SAUL BELLOW, NOBEL 1976

Lexues tepër serioz të
botës, kini kujdes!

(fq. 14)

I intervistuar ndërsa po priste trenin për të shkruar në Boston, E. M. Forster-i u pyet se si ndihej në prag të vizitës së tij të parë në Harvard. U përgjigj se kishte dëgjuar që kishte disa lexues tepër serioz të librave të tij atje...

KADARE

Koncert
në fund
të stinës



roman
Onufri

Romani “Koncert në fund të dimrit”

RRËFIMI PËR KINËN, NË FAKT, ËSHTË NARRATIVA PËR KOMUNIZMIN SHQIPTAR

Dr. Ilir Yzeiri

(fq. 6)

Këtë roman e kam dashur veçanërisht, e kam pëlqyer dhe e kam ruajtur në kujtesë, natyrisht, më shumë si frymë, por e sillja ndër mend sidomos atëherë kur një ndjenjë të zymtë apo një trishtim çfarëdo, më duhej që ta bashkëshoqëroja me diçka të shkruar...

IVAN BUNIN

(ÇMIMI NOBEL 1933)

DITËT E MIA TË NOBELIT



BIBLIOTEKË

Agron Tufa

(fq. 10)

Tre tregime

Rexhep Ferri

(fq. 11)

*Është vonë për të
besuar*

Giuseppe Schirò
Di Maggio

(fq. 11)

Metafora

Reflektim i përkthyeses Albana Shala për romanin “Uria” të shkrimtarit J. Ouariachit

**NJË UDHËTIM PËR BOTËN,
JETËN DHE VDEKJEN**

Një burrë i qeshur, interesant, shprehës dhe herë-herë hokatar, njeri që s'bie kurrë në dëshpërim, të cilit vetëm i hanë duart për punë, njeri me humor të mirë, gjithnjë i shkujdesur dhe plot batuta të thukëta...

Roland Dasho, Skënderbeu i vogël i filmit

Intervistoi: Xhevair Lleshi

XH. LL. - Kur u zbulove që je ti Skënderbeu i vogël i filmit?

R. D. - (Qesh) Në shikim të parë ashtu duket, sikur jam vetëzbuluar, por unë këtu kam qenë, në punë, në shtëpi, me shoqërinë, njerëzit e mi, me *kujtimet*. Po edhe me facebook-un, të cilit hera-herës i hedh një sy. Ja ky u bë shkaku. Lexova një ditë se Kom Nova dhe Shaban Polovina, beratas natyrisht, kishin qenë figurantë në filmin «Skënderbeu» si shumë të tjerë. Edhe imë 'më ka qenë një nga valltaret në dasmën e Skënderbeut, që u luajt në sheshin e kishës së Drobonikut në Berat. Imë 'më u bë shkak, se më merrte në sheshet e xhirimit.

Isha klasa e parë në fillore... Dhe thashë, pse të mos e shkruaj edhe unë në facebook? E shkrova dhe kaq. Më pas e hase ti dhe bëre atë që di më mirë, e shkrove. Dhe ajo bëri bujë...

XH. LL. - Ç'skena janë luajtur në Berat te ky film?

R. D. - Nga koha e xhirimeve mbaj mend veten kur më hipën në kalë. Kisha shumë frikë. Por ajo që shoh në film më bind se e kam tejkaluar frikën. Është zgjuar madje një lloj krenarie. Por skenat në film të luajtura në Berat janë të shumta, sidomos në Kala dhe në Drobonik, në Ullishtë... Në një farë mënyre

filmi u hakmor nga *Betejës së humbur të Beratit*, një nga të vetmet e humbura, sepse thjesht i besoi pritjes, sinqeritetit, kurse triumfoi dhëlpëria e ndyrë osmane, duke dërguar lajmës të fshehtë nga shkëmbi Çekbeni i Kalasë...

XH. LL. - Sa mendon se të qenit i pranishëm në filmin Skënderbeu ka luajtur rol në jetën tënde?

R. D. - Për mua aq mbetet. E them në një kuptim simbolik. Si të thuash më ka mbushur si motiv dhe ka hequr një fill të pakuptueshëm të brendshëm gjatë gjithë viteve të shkollimit, studimeve dhe të punës, kurdoherë. Jo se mbaja portretin e Tij para syve, por portretin e kisha së brendshmi, udhëheqës që më nxiste: duhej patjetër të isha i pari (jo i dyti, se e ka lënë Enco Ferrari në librin e tij, që i dyti është i pari i humbësve!). Dhe kjo moto ma ka shpërblyer. Jetoj bashkë me mua. Madje edhe tek fëmijët e mi e më tej...

XH. LL. - Po ç'je ti, Roland, në fakt?

R. D. - Unë jam djali i vogël i filmit «Skënderbeu» që dërgohet peng te sulltani. Gjergji i vogël, Gjergj Kastrioti Skënderbeu i ardhshëm, mbreti i shqiptarëve që do të spikatej me zulmë të madhe, luftëtari dhe diplomati habitës, njeriu që i dha famë shqiptarëve dhe luftës së tyre kundër Perandorisë Osmane....

XH. LL. - A i mjaftojnë çdo njeriu ato pak çaste të mbetura në film?

R. D. - Kjo është vetëm një sekuençë që i jep tjetër kredit personalitetit të një njeriu të mësuar, të shkathët intelektualisht, i jep zë të veçantë dhe kur të mos jetë më do kërkojnë të dinë më shumë për Rolandin, jo thjesht si një student i zoti i biokimisë, as edhe si profesionist dhe as si një njeri që di t'i organizojë mirë punët që bën. Po vetëm për këto tri-katër minuta, pa e ditur sheshpushimin dhe sheshveprimin e filmit, pa ditur rrethanat që më çuan deri te filmi, derisa regjisori i vuri vulë. Çdo njeriu i mjaftojnë ato pak çaste të mbetura në film, me kulmin e emocionit të përfutur. E vërteta është se ai çast magjik, sidomos pse je fëmijë, bëhet nxitje e papërfytyrueshme për tërë jetën, por gjithashtu sot është një tjetër dritare për t'u parë krejt ndryshe. Ndryshe në çdo hap. Po pse jo edhe për të mbetur trashëgim, edhe si pasuri. Se, fundja nuk është filmi «Dhe vjen një ditë...», sigurisht pa ia mohuar rëndësinë...



Roland Dasho para përkrenares së Skenderbeut (ardhur nga Vjena)



XH. LL. - Ç'fëmijë ke qenë ti Roland?

R. D. – Isha thjesht i vogël, fëmijë, i shënuar nga fati pse jo, djalë i rrëmuishëm dhe i përkëdhelur, që do të mbetesh përfjetë në celuloid, duke sjellë diçka madhore në kujtesën kombëtare, do të isha për këdo djali i fundit i Gjon Kastriotit dhe do të merrej peng nga sulltani. Kur e vështrojmë në sy të vërtetën e tmerrshme të asaj kohe, barbarizmin dhe energjinë e saj, atëherë mund ta ndiejmë edhe më thellë emocionin që vilet edhe sot e çdo kohë.

XH. LL. – Dhe i ke bërë një përgjithësim filozofik atij çasti magjik?

R. D. – Po, por ama një filozofi timen. Në raste të tilla kushdo mund t'ia vërë fajin jetës, madje mund ta mallkojë atë e të nënvizojë me psherëtimë të thellë se sa e tmerrshme qenkej kjo jetë! Për këdo *rrëmbimi* mund të ishte një zhgënjim i llahtarshëm, sepse fëmija, i mbrojtur tek e fundit edhe nga një instinkt madhështor i prindit, nuk mund të «dhurohet» ashtu, nuk mund të jetë si plaçkë. Por ja që, siç e dimë nga historia, ky zakon barbar dhe aq i hidhur, kështu lozte me fatin e njeriut. Me fatin e Skënderbeut tonë, po edhe me fatin e kujtdo tjetër personazh. Por kjo më bën ta shoh veten thellë në sy, pa menduar hollë se ç'mund të sillte ky episod, por krejt i veçantë, që do të mbetej i fiksuar në të gjitha lëvizjet e mësuara e mbi të gjitha të mijat.

XH.LL. - E ke të fiksuar vendin ku ka qenë sheshxhirimi?

R.D. - Ata që jetojnë në lagjen «Kala» të Beratit e dinë ku është kisha e Onufrit, katedralja e Shën Mërisë, ose muzeu i veprave të tij, Muzeu kombëtar «Onufri», e njohin sheshin para tij edhe sikur të ndodhen në situata të papërshtatshme, madje edhe në grahmat e fundit të jetës...

XH.LL. - A ke medituuar ndonjëherë për situatën filmike?

R.D. - Besoj që shumë herë. Se dihet që fëmijët nuk u shpëtojnë dot «së tyre», pjesës më interesante, sado që ne shpesh na pëlqen të themi «të mësuarës». E mësuara është aty, sigurisht, por e tretur brenda kuptimit që i jepte ky djalë i vogël i filmit (do të thotë edhe Roland Dasho), derisa më në fund regjisor i të kënaqej me veprimin, zërin, sjelljen, lëvizjet, si ta

hipnin mbi kalë për të kalëruar me një «osman» drejt zemrës së Perandorisë së madhe, aty ku ishin jeniçerët, aty ku ai (unë, gjoja) do mësonte forcën dhe kulturën, gjuhët, diplomacinë, por që, siç e dimë do të mbetej shqiptari më i madh i të gjitha kohërave! Sido-sido kjo më gicilon sapak...

XH.LL. - Si thua, rrugicat e Kalasë së Beratit krenohen me episodet e filmit?

R.D. - Rrugicat e kalasë së Beratit, e di që krenohn me episodet e filmit «Skënderbeu», pasi ato dhe eleganca e tyre e përsosur janë lënda e gatshme mesjetare që i dhurohet filmit. Aty hidhej sera, uji i vluar, aty ngriheshin shkallët dhe para mureve zhvilloheshin betejat e mëdha të historisë sonë. Por rrugicat dhe muret nuk kanë gojë të tregojnë. Rrugicat dhe muret e heshtur janë e do të jenë aty me një pëshpërimë plot dalldi, se ato kanë qenë dikur, pa dashjen e tyre, natyrisht, sfida e madhe e Skënderbeut, zulma e tij, pse jo edhe turpi i madh, helmi dhe thika pas shpine, fusha e mbjellë me të vrrarë (vetëm ulla të janë dëshmitarët e historisë!)... Por ja që edhe e hidhura e madhe kthehet në mjalte. Vetë Kalaja e Beratit mori hak për vete, derisa e bindi me një thjeshtësi të madhe regjisorin që aty të zhvillohej veprimi, pa e ditur ndoshta historinë, veç t'ia kenë treguar aktorët shqiptarë gjatë ndenjjes në sheshpushim...

XH.LL. - A ke ndonjë mendim për karakterin në film?

R.D. - Dikush do të thoshte se karaktereve njerëzore që vepronin në film këto rrugica u kanë dhënë fisnikëri dhe kjo ka mbetur përgjithnjë në imazhin e filmit. Aq më tepër që filmit i intereson sidomos karakteri. Këta i kemi në të përditshmen tonë, me ta mund të përhëndetemi, siç ndodh fjala vjen me mua, si për ta bërë sot krahasimin me kureshtje të fortë jo vetëm për t'ua rrëfyer njerëzve. Por, megjithatë, kjo është edhe histori argëtuese, e tillë edhe për vetë personazhin, ndonëse e veshur me petk interesant dhe të jashtëzakonshëm, që mbart me kujdes tharmin «e kohës», shoqëruar me fytyrën e ashpër (luftëtarët), naivitetin, sjelljen e zakonshme e shoqëruar me virtytin e rrallë që fal me vulë të përfjetshme magjia e kinemasë...

XH.LL. - Si e imagjinon ngjarjen kur ke luajtur rolin e famshëm që fati ta dha?

R.D. – (*Qesh*) Hm. Rolandi i vogël luante rreth e rrotull këmbëve të aktorëve, nuk përmbahej në kënaqësinë e vet, se aq shumë njerëz nuk kishte parë ndonjëherë, aq shumë kostume popullore, aq shumë ngjyra, aq shumë skena, aq mrekulli që i binin nga qielli. Aty shtroheshin dreka e darka, aty kishte shumë verë, pihej e këndohej, aty luhej luftash, vrapohej, kishte aq shumë kuaj të bukur sa ai vogëlush (*qesh si nën buzë*) s'kishte parë kurrë në jetë. Një botë e mrekullueshme. Regjisor i do ta ketë parë në prehrin e së ëmës dhe do të ketë bërë titull «E gjeta Skënderbeun e vogël! Është i mrekullueshëm!» Mamit, domethënë së ëmës së Rolandit do t'i ketë rënë atë çast një nur tjetër, siç u bie zakonisht nënave kur flitet për bijtë e tyre. Por regjisor mund ta ketë pikasur edhe në sheshe duke luajtur, duke mbledhur ndonjë lule, duke e parë në sy fytyrën e mahnitur nga lëvizjet e dendura të «luftëtarëve», me aq shumë armë, klithma dhe vrapime sa që do ta ketë pasur të vështirë të mos habitej. Atëherë regjisor do ta ketë ngritur në krahë, duke e çuar lart, rrahur nga rrezet e diellit. Se fytyra e kujtdo vogëlushi të mahnit, dihet. Ai sikur të vinte nga thellësia e historisë do të mbinte aty në sheshxhirim si djali i fatit të plakur, si biri i një komiti të pamësuar me atë çfarë ndodhte rreth e qark. Ai më mirë se çfarëdo tjetër mund të bënte vrima në tokë me një copë dru, mund të imitonte një makinë, një kalë, një shpatë. Ta filmoje lëvizjen ditore, veprimet dhe habinë e tij të jashtëzakonshme, kjo kishte për të qenë një magji më vete... Një magji dhe shkollë për ata që studiojnë psikologji. Jam i bindur se kushdo që do ta shihte kështu vëmendjen e kamerës do të mahnitej me këtë sy regjisorial...

XH.LL. - M'u duke i frymëzuar. Pse?

R.D. – Kujtesën, frymëzimin dhe imagjinatën m'i ka dhënë dhe forcuar mëma, duke ma nanuritur si rrëfenjë të vjetër, pse jo edhe si përrallë të bukur...

XH.LL. - Ta ka përmendur kush këtë fakt, në CV, apo e ke pasur si kalë belaje?

R.D. - Një shenjë kaq e bukur dhe sigurisht emocionuese, nuk mbetet në harresë. Po edhe unë, nuk se protestova ndonjëherë që nuk ma përmendnin

këtë fakt dominues, të cilin do të doja shumë t'ma zinin ngoje, sigurisht nuk kundërshtova askënd, i ndershtëm në kumtin e ditës, rrethuar me heshtje të ftohtë, ndërsa zemrën - sikur më thërriste - ma linin të paktën t'më rrihte në kraharor. Nuk mund ta kërkoj famën, por sido nuk kam harruar gjë, mbeta gjithnjë stoik, nuk kërkoja të merrem me letrat vetëm se më pëlqen fort letërsia, u hedh parfumin e filmit tregimeve dhe poezive që lexoj dhe mbaj për vete një dhimbje të bukur...

XHLL. - M'u duk se doje të shtojë diçka, apo...?

R.D. - E pra, unë jam nga Berati, më pëlqen që mbeta «Skënderbeu i vogël i filmit». Kam si shenjë filmin e madh «Skënderbeu», film që e bëri aq të njohur Shqipërinë, më solli edhe mua fat të paparashikueshëm, sepse u lidha pazgjidhshmërisht me Beratin, qytetin tim dhe e kuptova se edhe Berati fitoi aq shumë nga ai film i madh. Por e fshehta mbeti magji për Beratin, ashtu edhe për mua.

XHLL. - E ke menduar ndonjëherë po të mos kishte qenë filmi «Skënderbeu»...?

R.D. - E çfarë pastaj po të mos ishte filmi

perëndia të tillë, të gjejë të domosdoshmen më të hollë, më të bukur, siç e krijoi Grabovi i madh, më të përshtatshme edhe kur është në humbëtitat më të harruara, edhe kur endet në prehrin e kotësisë, edhe kur jeta e zhyt në gjanën e banalitetit, edhe kur është tronditur aq thellë jeta e tij e krisur...

XH. LL. - Mos është një ndjenjë që përfundon si shaka?

R. D. - Kështu do të më pëlqente ta rigjeja edhe njëherë fëmijërinë time, paçka se ato tri-katër minuta, ajo sekuencë e përgatitur me aq mundim e thjeshtësi më detyron shpesh që të vë buzën në gaz. Ne, sigurisht, i pëlqejmë gjërat e mira e të bukura pasi kanë kaluar, sepse habia e kohës së vërtetë nuk na lë rehat, na shtyn ose na tërheq, na detyron nganjëherë ta mendojmë ndryshe, si një provë e dështuar, edhe pse imitimi na rrëmben. Mahnia e fëmijës: të bëjë sikur! Detajet (ah sikur të m'i gjenit ato, sa mirë do të qe!), do të kenë qenë shprehëse, paksa të çuditshme, do të më kenë zënë në befasi, mbushur plot pandehma e sekrete (sekretet e asaj moshe janë një tjetër mrekullí dhe duhet thënë se më i forti është pikërisht ai që mbart sekrete të mëdha!), një sugjestion i çmendur, edhe pse ia beh aq

XH. LL. - Ç'të ka mbetur nga ai vit i largët, kur luhej në Berat filmi «Skënderbeu»?

R. D. - Ndoshta pak trishtim, po aq edhe mërzë, ildisur me një shaka të kërthndezur, e jeratisur si keqardhje, e pra, pak jetë. Mbaron filmi, pastaj fillon loja, arratisur nga e vërteta. Të vërtetat që pa dashjen tonë na injektoheshin në gjak. Një rreth vicioz gjërash ku mbytemi nga pak për ditë, po edhe lumturohemi përditë, të heshtur dhe të mahnitur se si na rrodhi koha kaq shpejt e pa kuptuar...

XH. LL. - Me sa di po përgatitet filmi dokumentar për xhirimet e filmit «Skënderbeu» në Berat?

R. D. - Ah sikur të ndodhë! Sa do të kisha dashur të isha takuar ndonjëherë me ata që luajtën filmin «Skënderbeu», do të doja që ishim edhe njëherë në sheshet brenda kalasë dhe të përcillja emocionin e asaj kohe të papërsëritshme. Nuk paskam qenë as atëherë i qetë, siç nuk u ndjeva kurrë në jetë, duke ecur në jetën time pa thekse të mëdha e pa bëma të atilla që të thosha se më shkonin, se po ecja edhe unë nëpër maja... Kjo, pikërisht kjo mbeti e fshehta ime, po në një farë mënyre edhe rreziku im - sepse më duhej të



«Skënderbeu»? Unë njëlloj do të vija si një mysafir i vonuar, do ta ndieja njëlloj frymën e ngrohtë të të tjerëve, se njeriut i ka lezet jeta pasi është bashkë me të tjerët Jo si tani me Coronavirusin. Do të guxoja në mendt e mia të isha pjesë e një filmi? Kurrë, sepse nuk u bëra dot ajo që më kaploi atëherë dhe në atë moshë. Kjo më duket e prekshme, pse jo edhe e besueshme! Nganjëherë them se shaka të tilla janë të bukura. Them po ashtu se sikur të isha unë Gjergji i vogël... Dridhem me një rrëmujë të pazakontë mendimesh dhe nuk e besoj se do të bëja dot atë vepër aq të madhe! Eh, të madhe! Dhe kjo ma fut më tej ngasjen, më bën të qesh e ta sulmoj veten time ashtu siç di unë, mbarë e prapë...

XH. LL. - Fëmija edhe kur s'ka mundësi filmi, për shembull, përsëri është i dashur. Si mendon?

R. D. - Fëmija kurrë nuk mendon gjatë. Tmerri i fëmijës është kur sjell ndërmend se mund të mos i ketë më prindërit e tij, por jo, sigurisht jo të luajë në zgjatimin e thekshëm të kohës, të qëmtojë me sy atë që i mungon, t'i pëlqejë edhe ato që brenda gjërave të zakonshme janë fare të mërzitshme. Fëmija nuk ka shpella në mendjen e vet, as bën plane, thjesht fëmija edhe kur s'ka asnjë mundësi është i dashur. E ka bërë

shpejt e shpejt sikur të ishte thjesht një tronditje dhe aq, një ndjenjë që përfundon si shaka...

XH. LL. - Egoizmi i fëmijës...më duket ruan një batutë për të?

R. D. - Po, po ta them: s'ka gjë më bukur se sa egoizmi i fëmijës! E ka gdhendur ime me në shënimet e filmit. Dhe më mbeti. Do të doja ta rijetoja, Zot i madh, dhe kudo të prezantoja as më pak e as më shumë veten time, që shpesh duket si aureolë mbrojtëse, bëhet pastaj edhe metaforë... Mendo, egoizmi fle mes ëndrrash, me siguri matematike - tejet të zmadhuara, se ndryshe nuk shkojnë, s'kanë pikë shijeje. Mendo, sikur të mos e kisha Skënderbeun në atë skenëz të paharrueshme a do të kisha mbetur pa ëndrra dhe a do të ndiheshia i mposhtur nga fati? S'e di, as e kam menduar ndonjëherë, por ama e di egoizmin e fëmijërisë sime, atëherë kur bëja diçka për t'u plakur, kur punoja rrengje, kur dëshiroja vetëm të bëja po atë jetë që bëja, të ngrija në këmbë entuziazmin e magjishëm të moshës, dhe t'ua tregoja plot mburrje të gjithëve se çfarë kisha bërë, domethënë atë që nuk bëja dot kur u rrita...

ktheja gjithnjë kokën prapa, pasi i prishja baraspeshat e çmendura dhe njëherazi të shenjtëruara. A thua se e kuptova ndonjëherë kotësinë e atypëratyshme të çastit? Kurrë! Çasti të kredh brenda pa u ndierë, pa u kuptuar, ashtu siç edhe të rrëmben, të bën për vete, si nën një furi të papërballueshme, si pasion që dikur do të vinte dhe unë do të bëhesha zot i vetvetes. Dhe i pari për mua do të mbetej emocion... A do të ndiheshia paksa keq kur t'i hipja tani, kalit të Skënderbeut? Por kjo s'mund të ndodhte se ishte kush t'më mbante në prehër...

XH. LL. - A të duket e gjithë kjo si një metaforë?

R. D. - Metafora mbeti e fshehur brenda jetës sime. Emocioni doli sheshit, jelekzbërthyer dhe si djalosh që të prish mendjen duke pasur nën vete një butafori sëkëlldisëse, mahitur me diçka krejt njerëzore e të vdekshme, në kulmin e gjërave të bukura që kam dëshiruar të bëj. Gjithçka sikur ndodh sa për t'u marrë me mend, si një mërzë e bukur që s'kthehet kurrë më. Dhe mbeta rob i atij çasti: Skënderbeu i vogël i filmit...

Tiranë, më 30 maj 2020

HERMETIZMI SI ALTRUIZËM I KUPTIMIT NË POEZINË E MARTIN CAMAJT

Yzedin Hima

Martin Camaj e ka kaluar fëmijërinë në viset epike të arbërisë, në Alpe. Imazhet e këtyre viseve herë – herë shfaqen befasuese në tekstet poetike, së bashku me fjalët curraj, karpa, korbi, gjethue, mjedërr, xhingalla, xhixhillojë, qokth etj.

Këto imazhe primitive të derdhura në kujtesë, nyjëtuar më vonë në format më moderne poetike, falë formimit letrar të autorit në atdheun poetik të Dantes, Leopardit, Ungaretit, gjithashtu edhe në mjedisin poetik gjerman të Paul Celan, Gotfrid Ben, Magnus Eczenzberger, formojnë yllësinë poetike të Martin Camajt, sa të largët aq edhe të prekshme, sa enigmatike aq edhe të afërt me kontinuitetin arbënor. Primitivia dhe modernia në tekstet poetike të Martin Camajt nyjëtohen të alternuara si formë dhe domethënie.

Poezia me titull “Xhelozia” mund të jetë më e shenjuara si e tillë. Gjenden dy simbole në këtë tekst: **Vida e butë** dhe **Pllumbi i egër**. Vida e butë simbolizon modernen, të kultivuarën, të sofistikuarën si formë, ndërsa Pllumbi i egër simbolizon primitiven me rrënjët e zanafillës, bukurinë e qendrueshme që po tretet në kohë dhe i ka shpëtuar kohës, sakrificën sublime në emër të dashnisë dhe të së bukurës, dhimbjes për zbutjen dhe humbjen e identitetit, etj. Teksti i Martin Camajt nuk i shpëton gjenezës epike të mbrujtjes së autorit, ndonëse lirikë, ka fabul dhe nis si rrëfim:

*Iku vida e butë në mal
Dhe në currat e ashpër
Gjet një pllumb të egër.*

Në leximin e parë inversioni përdoret për të shenjuar veprimin e Vidës: *iku*. Çdo ikje ka një arsye, që fillon nga ato më të rëndomt, deri te arsyet madhore. Ky kalim ka një arsye tejet grishëse, të parezistueshme: Vida e butë kërkon takimin me Pllumbin e egër. Dy të kundërtat e kërkojnë njeri – tjetrin për t’u bërë një:

*Në çerdhen e vjetër në shkamb
puhija e ngrohtë e majit fryn
e u rrqeth ndër qeta çdo lule e gjeth
në kënaqsi pa skaj.*

Martin Camaj nuk tregon veprimin, por rrjedhojën dhe efektin për të shenjuar energjinë shpërthyesë të takimit, që ndikon krejt mjedisin rreth e rrotull dhe shpërndahet nga puhija e majit në tërë habitatin. Takimi ndodh në çerdhen e vjetër.

Leximi i dytë i tekstit të shtyn drejt zbulimit të ecencës krijuese të Martin Camajt. Forma moderne poetike – Vida e butë, kërkon të takohet dhe të çiftëzohet me primitiven, zanafilloren,

origjinalen, substancën – Pllumbin e egër, për të lindur më pas tekstin, poezinë moderne të nyjëtuar nga një Vidë e butë – *forma* dhe një Pëllumb i egër, ekzotik, *substancia*. Një arsyetim i tillë të çon te kodet e artit të Martin Camajt dhe te dekodifikimi i tekstit të tij poetik. Po cili është çelësi, instrumenti që na dërgon në këto dyer?

Vargu i poezisë: “**në kënaqsi pa skaj**” na tregon se ky takim nuk është një takim i thjeshtë të dashurish, por shumë më shumë. Kënaqësi pa skaj zor se të jep dashnia, seksi, por diçka shumë më sublime dhe ky është nyjëtimi i tekstit të arrirë, arti. Vetëm arti i madh nuk ka skaje kënaqësie estetike. Dikush shkroi se i shtrirë përmbys në krevat, duke lexuar poezi të mira, ndjente kënaqësinë më sublime, që të jep një pozicion i tillë.

Në pjerrinën e kësaj persiatjeje mund të sjellim edhe pamje të tjera në të mirë të mendimit. Pasi forma dhe përmbajtja, modernia dhe zanafillorja nyjëtohen e bëhen një, shfaqet teksti poetik në formën e pëllumbtë, që sjell një fatbardhësi mali:

*Kur mbrrini mbramja vida
dhe pllumbi
fluturuen tue pru ndër krahë
një fatbardhësi prej malit.*

Nëse jemi të kujdesshëm në lexim, vërejmë se Vida dhe Pllumbi i kanë humbur epitetet *e butë* dhe *i egër*. Nuk flitet në tekst më për Vidën e butë dhe Pllumbin e egër. Po çfarë ka ndodhur? Substanca (e egër), është tretur në formë (e butë), duke u nyjëtuar në “fatbardhësi prej malit”, tashmë në një tekst poetik, ku forma dhe përmbajtja janë një. Teksti poetik realizohet te lexuesit, në rastin tonë te gjindja:

*Kah një balkon me gjind
Vida kryet e uli,
Ajrin teposhtë tue pre.*

Po çfarë po ndodh me Pllumbin? Substanca, zanafillorja reziston fort, kurrësi nuk mund të durojë metamorfozën në formë, aq më tepër në një formë tejet moderne, siç është teksti poetik hermetik, që fsheh apo humb krejt kuptimin, teksa shfaqen simbolet si ajsberg në trupin e tij:

*“Ku, ku!” e pyeti pllumbi i egër,
Por vida s’ndogjoi e për nën pullaz
Në çerdhen e vet ra.*

Takimi i tekstit me lexuesin është një takim sa misterioz aq edhe grishës. Është çasti i realizimit të tekstit si nyje artistike e kuptimore tek receptuesi. Ky takim është pothuajse po aq mistik sa takimi i formës (Vida e butë) me

përmbajtjen (Pllumbi i egër) dhe nyjëtimi i tekstit, që ndoshta nuk përfundon kurrë si proces, derisa do të ketë lexime dhe rilexime të tij:

*Pllumbi pau në largsi një dorë
Njeriu që vidën kapi
E prapë një tjetër qafë e krye tue i lmue*

Kur vëren Vidën e bukur, (Le ta emërtojmë këtë lloj teksti me termin teksti primomodern) tek vërtitet në duart e gjindjes, Pllumbi i xhelozuar vetsakrifikohet, siç sakrifikohet domethënia për formën në tekstin hermetik:


*Në fyt, ndër krahë
Helm iu ba tashmë pllumbit ajri:
Fluturoi mbas rrezeve të fundit,
Ra në diell dhe u dogj.*

Poezia “Një ditë e ka dhe korbi”

*...Kur te e vona pllumbat kthyen në
banesa,
e ndieu vehten korbi pllumb në shpirt.*

Poezia e Martin Camajt “Një ditë e ka dhe korbi” është një tekst poetik simbolist. Ndryshe nga tekstet simboliste, ku përpjekja për gjetjen e mesazhit kuptimor kalon në një aventurë estetike me rrezeve të ndryshme, ku duhet të eksplorosh figura e kuptime në rrëpira gjuhe e hone pa dritë, aty ku rriten lule të egra me aromë mahnitëse dhe ekzotike, që rrallëkush i gjen dhe i provon, ky tekst dekodifikohet disi më lehtë për shkak të simboleve si korbi dhe pëllumbi, të cilët janë mjaft të njohur e ndriçuar në ligjërimin poetik të traditës folklorike arbërore. Korbi, zog i përzishëm si simbol i vdekjes dhe zisë, ku forma dhe substanca bëhen një, në të folmen e përditshme përdoret si simbol i trishtimit dhe fatkeqësisë: Korba unë për ty! – është psikama e nënës për birin e humbur. Ndërsa pëllumbi është zog që simbolizon paqen, harmoninë, qetësinë, shpresën, lajmin e mirë.

Poezia “Një ditë e ka dhe korbi” nis si në rrëfimet e vjetra biblike:/Erdhi një korb te dheu i butë nën shkrep/. Në habitatin e pëllumbave, korbi vëren si ai “s’dinte me ndjekun vallet e pëllumbave”,



nuk dinte të mbante “ritmin e flatrave ndër valle”.

Në respekt të të ndryshmëve, korbi nuk e përzit vallen, nuk nxjerr zë, me kujdesin se krrokama e tij do ta bënte pis ajrin, do ta ngjyente me zi. Befasia e këtij teksti vjen nga kontrasti, përballja e dy sistemeve të ndryshme të vlerave: ai i pëllumbtë mes gazullimit të përgjithshëm dhe ai i korbtë melëmshin e zi të trishtimit që shthuret dhe përhapet ngadalë në fusha e pjerrina me krra-krra-krra.

Në këtë përballje Jetë - paqe – shpresë – lajm i mirë – në njërën anë dhe Vdekje – trishtim - zi, krrokamë në anën tjetër, butësisht triumfon jeta. Korbi ngrin, hesht, i vetdijshëm për atë çka përfaqëson, mahnitet dhe hutohet, gjithmonë me kujdesin për të mos u shfaqur dhe për të mos prishur bukurinë e habitatit të të tjerëve. Poezia mbaron me vargjet: Kur te e vona pllumbat kthyen në banesa,/ e ndieu vehten korbi pllumb në shpirt./

Çfarë ndodhi?!

Ndodhi metamorfoza, që nuk përfshiu pamjen, zërin, por shpirtin e korbit. E zeza, e përzishmja, ka ndryshuar së brendshmi. Ka triumfuar e mira, jo në pamje, jo në formë, por në substancë. Metamorfozat ndodhin në rastet kur ndodhin trauma të forta shpirtërore. Cila qe ajo forcë që e detyroi korbin të ndihej pëllumb në shpirt?! Arti? E bukura? Paqja? Shpresa? Lajmi i mirë?

Ndoshta të gjitha. Krejt si në një shfaqje teatri, ku pëllumbat janë artistët që luajnë në skenë, ndërsa korbi është spektatori i vëmëndshëm dhe i ndjeshëm. Loja në skenë e pëllumbave, krahas kënaqësisë hedonistike, nxiti te korbi i ndjeshëm efektin që shkakton çdo lloj art, katarsisin, pastrimin shpirtëror.

Teksti ka nëntë vargje gjithsej. Martin Camaj është mjeshtër i poezisë eliptike, ku me pak fjalë end një pëllhurë poetike sa të bukur aq edhe hermetike. Në këtë tekst shohim vetëm efektet, jo veprimin. Mungon narrativja, e cila rrjedh poshtë vargjeve të kursyer dhe, me një vrull e energji në vetdijen e lexuesit, ku ndërtohet tërësisht kuptimi dhe zbulohet nyjëtimi artistik, që sjell kënaqësi estetike. Lexuesi mbetet i mahnitur nga efekti, që shkakton e bukura, e cila e bën korbin të ndihet pëllumb në shpirt. E bukura është energji pozitive, që mund të transmentohet nga një burim te objektet përreth dhe të ndryshojë pikërisht substancën e këtij objekti, në këtë rast, shpirtin e korbit. Jo vetëm ta ndryshojë, ta pasurojë, por edhe ta shndërrojë nga të korbtë në shpirt pëllumbi.

Dikush tha se e bukura është “materiali” më i qendrueshëm. Sidomos e bukura e shpirtit. Dhe në një farë mënyre ka të drejtë sepse një fytyrë e bukur plaket dhe e humb bukurinë, ndërsa një shpirt i bukur nuk ndryshket dhe nuk plaket kurrë, ndaj dhe Martin Camaj vëren se ndryshimi, shndërrimi ndodhi pikërisht te esenca e korbit, kur ai u ndje në shpirt pëllumb.

Romani “Koncert në fund të dimrit”

RRËFIMI PËR KINËN, NË FAKT, ËSHTË NARRATIVA PËR KOMUNIZMIN SHQIPTAR

Dr. Ilir Yzeiri

Këtë roman e kam dashur veçanërisht, e kam pëlqyer dhe e kam ruajtur në kujtesë, natyrisht, më shumë si frymë, por e sillja ndër mend sidomos atëherë kur një ndjenjë të zymtë apo një trishtim çfarëdo, më duhej që ta bashkëshoqëroja me diçka të shkruar.

Për mua, por edhe për brezin tim, besoj, Kadareja ishte si një lloj limani i pandotur, i ndodhur në një utopi që ne të gjithë ëndërronim ta jetonim, ta gjenim mes nesh apo ta projekttonim si fat në jetën që vinte, por që e arrinim vetëm gjatë kohës që ishim në kontakt me shkrimin e tij, sepse, nëse ka një gjë që e bën atë të magjishëm, është pikërisht të shkruarit, të hartuarit e një teksti, ajo që në frëngjisht, ndoshta, shprehet më mirë - *«l'écriture»*.

Me qenë se e ruaja kështu në vetëdije, para disa vjetësh, shkaktova një «furtunë» mes ish-ambasadorit të SHBA-së në Tiranë, z. Arvizu dhe gazetës «Shekulli»¹ për shkak të një termi që unë pata përdorur në shkrimin tim, të cilin e kisha ruajtur më shumë si shenjë të një ligjërimi hipokrit, pa kuptim dhe qesharak, gjithashtu. Në kohën e marrëdhënieve me Kinën dhe më pas, ne e përdornim rëndom termin «kinezëria». Mirëpo unë pata përmendur romanin «Koncerti» dhe, pa dashje, kisha thirrur në kauzë edhe Kadarenë. Për fat të mirë, opinionimi më i madh u sqarua se jo vetëm te unë, por as në romanin e Kadaresë nuk kishte asnjë fije insinuate nga ato që kishte keqkuptuar zoti Arvizu. Më pas, ky i fundit i mirëkuptonte të gjithë ata që e shanin dhe e fyenin. Nga fundi i karrierës në vendin tonë, sulmet e ndaj tij nga PD-ja u bënë aq banale, sa shkrimi im dukej si një lëvdatë për të, por kjo është një gjë tjetër.

Bota e gjithë po kalon një nga traumat më të mëdha për shkak të koronavirusit, për të cilin dihet shumë pak, por ama dihet me siguri një gjë: ai u shfaq për herë të parë në një qytet të Kinës me emrin Vuhan. U përhap që andej në gjithë botën dhe i ka shkaktuar asaj një nga tragjeditë më të mëdha, sidomos ekonomike, dhe ka frenuar globin. Disa udhëheqës shtetesh i kanë kërkuar Pekinit që të tregohet më i hapur dhe të bashkëpunojë me ta në mënyrë që të kuptohet më mirë se çfarë ka ndodhur, por ende asgjë. Gjithçka është një mister. Midis pretendimeve të SHBA-së, Gjermanisë, Francës dhe Australisë, nga njëra anë, që kërkojnë më shumë informacion nga Kina dhe Kinës komuniste që pretendon se nuk ka ç'të japë më dhe se këtë punë e kanë në dorë shkencëtarët, unë preferoj të jem në anën e SHBA-së, Gjermanisë, Francës, Asutalisë dhe gjithë atyre që bëjnë përgjegjëse Kinën për misterin e lindjes dhe përhapjes së koronavirusit dhe për gjuhën e drunjtë, për mungesën e komunikimit të hapur, karakteristikë kjo e vendeve totalitare dhe gjysmë të hapura siç është Kina apo Rusia e Putinit.

Pikërisht kjo polemikë dhe hutimi, misteri dhe mungesa e qartësisë në Kinë, apo vdekja e një mjeku dhe zhdukja e atij që zbuloi i pari virusin, vdekja e një tjetri që ishte, po ashtu, ndër të parët që u përball me të, frika² e gazetarëve që po investigonin mbi këtë virus, më shtynë një ditë që t'i rikthehem edhe njëherë romanit të famshëm të Kadaresë «Koncert në fund të dimrit» jo aq për të kuptuar se çfarë po ndodh sot, por për të rifreskuar memorien time me një nga kryeveprat e letërsisë botërore që zbërthen në mënyrë të thellë kodin e moskomunikimit dhe bën grafinë e krimeve të diktaturave komuniste me një qartësi tragjike në një nga ish-perandoritë komuniste të botës që pati si lider Mao Ce Dunin, figurën më komplekse dhe më gjakatare të Kinës së re.

Nuk besoj se ka tjetër roman në hapësirat eurolindore që të ketë përshkruar me aq thellësi e aq tragjicitet krimet e komunizmit kinez, por edhe krimet e diktaturave komuniste, sa ky roman. Nuk besoj se mund të gjendet tjetër vepër që të ketë në narrativë revolucionin kulturor në Kinë dhe përmendjen e krimeve monstruoze atje ndaj shkrimtarëve dhe artistëve kinezë, në një kohë kur maoizmi dhe maocedunideja kishte trullësuar edhe një pjesë të mirë të Europës.

«Gjakftohtësia»

Me këtë titull Kadareja e dërgoi në Shtëpinë Botuese «Naim Frashëri» romanin, i cili, më vonë, do të dilte me titullin «Koncert në fund të dimrit». Atë, siç thotë ai vetë,

e kishte shkruar nga vitet 1978-1981 dhe pikërisht në vitin 1981 e dërgoi për botim. «Është romani më i rëndësishëm» - thotë ai në një intervistë në «Panorma».³

Kjo vepër, në dorëshkrim, fitoi çmimin e parë në një konkurs kombëtar që ishte shpallur atë vit (1981), por, befas, u ndalua dhe nuk u botua. Doli në shtyp në vitin 1988. Në librin e përgatitur nga prof. Shaban Sinani me dokumente të arkivit të ish-KQ të PPSH-së dhe posaçërisht të zyrës së Shtypit e të Kulturës të atij aparati, me titull «Një dosje për Kadarenë»,⁴ në dy recensione jepen arsytet se përse nuk duhet të botohet ky roman. Kur i lexon sot ato dokumente, çuditësh me qartësinë ideologjike që kishin shkruar e tyre. Në ato raportime, ata, ashtu si murgjit e Mesjetës që analizojnë çdo paragraf e zbërthejnë çdo nëntekst, janë munduar e ia kanë dalë që të kapin thelbin e vërtetë të romanit. Sipas meje, ky paragraf që do të citoj më poshtë, e ilustron më së miri idenë se aparatçikët e regjur të Zyrës së Shtypit dhe të Kulturës në KQ të PPSH-së ishin të stërvitur dhe kishin nuanjat të hollë për të kuptuar e për të ndarë letërsinë propagandistike nga letërsia e vërtetë moderne dhe e pandotur me dogmat e socializmit. Ja shprehja:

«Romani «Gjakftohtësia» është një satirë dhe përqeshje me socializmin, me parimet dhe idetë e tij. Kjo satirë dhe tallje fshihet nën idenë e goditjes së «socializmit» kinez dhe të «majtizmit» të tij. Gjer këtu është disi e fshehtë. Por ajo shfaqet haptazi pastaj në faqet e romanit përmes ideve dhe frazave të dykuptimita, me të cilat është mbushur gjithë vepra.»⁵

Dhe pak më tej :

«Një ide krejtësisht e shtrembër e romanit është dhe ajo e luftës së liberalizmit kundër obskurantizmit, apo e Azisë me Europën, e «kinezërisë» me «europëizmin»... Për autorin gjithë problemi është që Shqipëria të ruajë «rezervat e europëizmit».⁶

Ndërsa që në hyrje të kësaj recense thuhet:

«Ne nuk mund të pranojmë që vepra të botohet dhe pastaj kritika ta hedhë poshtë. Për të evituar këtë, nuk do të lejojmë të botohet. Nuk duam të çorientojmë opinionin publik, sidomos në këto situata.»⁷

Studiuesin australian Peter Morgan e kam njohur nga afër dhe e kam shoqëruar në Gjirokastër kur ai erdhi para disa vjetësh në vendin tonë për të njohur më mirë Shqipërinë

3 <http://www.voal-online.ch/index.php?mod=article&cat=INTERVIST%C3%8BPRESS&article=13828>

4 Shaban Sinani, Një dosje për Kadarenë, botim i OMSCA-1, Tiranë 2005, dokumenti 29, 30, faqe 304-312

5 Shaban Sinani, vep. e cit., fq. 310.

6 Po aty, fq. 311.

7 Po aty, f. 309.

dhe, sidomos, vendlindjen e Kadaresë përpara se të botonte një nga veprat më të plota e më të mira të shkruara nga një i huaj për shkrimtarin tonë. Për «Koncertin», edhe ai ka vënë re «lojën e dyfishtë» të Kadaresë me paraqitjen e diktaturës.

Ai shkruan :

«Prezenca kineze u pasqyrua në një kohë kur ishte politikisht e pranueshme që ish-aleati të paraqitej në mënyrë negative. Megjithatë, edhe këtu, ashtu si te «Dimri i madh», mesazhi është i dyzuar. Mao Ce Duni këtu përfaqëson pushtetin shtypës dhe shpirtin e robërisë, por ai është pasqyrim i të gjitha diktaturave, përfshirë edhe atë shqiptare. Ky është kyçi i «lojës së dyfishtë» të Kadaresë që përmban kompromis dhe kritikë. Këtu, depërtimi i tij në brendësi të diktatorit doli profetik. Ndërsa paraqitja e kinezëve është një stereotip negativ, gjë që çoi në akuza për racizëm, kritika drejtohet kryesisht ndaj figurës së Maos dhe habitus-it kinez, si simbol i shtrembërimit të jetës në diktaturë»⁸

Ndërsa me rastin e botimit të tij në SHBA në anglisht, *New York Times* nën titullin «The thrill of burning bridges» të Robert D. Kaplan shkruante:

«*The Concert*» switches back and forth between Albania and China. Because Mr. Kadare is describing China mainly through the eyes of his Albanian characters, the sections on China are more impressionistic than realistic. Yet Mr. Kadare has in fact spent his life in a brutal Communist police state. The reader gets the feeling that the author knows his territory: his impressions ring true, and his irony, however exaggerated, is fitting.»⁹

Nga të gjitha këto vlerësime për romanin, një gjë bie në sy: «Koncerti», përmes anatomisë së krimit komunist në Kinë, vizaton tragjedinë që ai shkaktoi në të gjitha vendet ku ishte aplikuar. Ndërsa, në qoftë se ke parasysh se pas prishjes me Bashkimin Sovjetik edhe Shqipëria imitoi modelin kinez të jetës dhe kur mendon se maocedunideja, apo modeli lejfenist i jetës, u bënë standarde të kërkuara nga masa e madhe e drejtuesve mediokër edhe te ne, atëherë nuk e ke të vështirë të ndiesh se ironia, satira dhe cinizmi me të cilat autori vizaton jetën në Kinë e Mao Ce Dunit, janë më së shumti ndjeshmëri për jetën pa ngjyrë që po shtillej edhe në Shqipëri.

Oazat europeiste të Tiranës

Romani që unë po analizoj, është botuar në vitin 1988, ka 701 faqe, me redaktor Pirro Mishën dhe botuar nga Shtëpisë Botuese «Naim Frashëri». Është radhitur me linotip, por ka një korrekturë gjuhësore të mahnitshme. Kam gjetur vetëm dy gabime fare të vogla drejtshkrimore. Atëherë ekzistonte kulti i gjuhës dhe detyrimi shtetëror për ta respektuar atë. Këtë anë mund ta kishim ruajtur nga diktatura, por kjo është një temë tjetër.

Si strukturë, romani është ndërtuar me kapituj dhe ka tetëmbëdhjetë të tillë. Secili syresh ndërtohet si histori e një personazhi, sepse ky roman është i tipit polifonik, (shumëzërësh) dhe narratori rrëfen për fatet e personazheve të tij duke qëndruar disa herë larg tyre, duke i vështruar ato nga lart dhe vetëm në disa raste, atëherë kur ai tregon për Skënder Bermemën, fjala vjen, ke parandjenjen se pas atij personazhi qëndron alter egoja e shkrimtarit, por jo ai vetë, me që atë vetë e gjejmë më shumë si një regjisor që drejton veprimin e heronjve të tij dhe e takojmë, më së shumti, në skenat që ndërtohen si rrëfime pavetore e që kanë formën e përshkrimeve gati biblike në fillim të kapitujve apo kur futen në mes të rrëfimit si refleksione që ngjajnë, më së shumti, me një zë *off*, që vjen nga lart.

Ndërsa, në një vështrim tjetër, sapo hap faqen e parë të romanit, ke ndjesinë sikur po vazhdon të lexosh «Dimrin e vetmisë së madhe» apo «Dimrin e madh», sepse është e njëjta atmosferë qytetare e jetës në Tiranë. Një apartament përgjithësisht komod që banohet nga një çift kryeqytetas që punojnë në sektorët e administratës publike, Silva në një ministri dhe i shoqi, Gjergji, në Ministrinë e Jashtme. Një lulishtar ka sjellë një vazo të madhe me një fidan limoni dhe ata e nxjerrin në ballkon. Limoni do të çelë vetëm në kapitullin e fundit. Kaq është dhe koha e rrëfimit, ka vënë në dukje një studiues. Gjergji është në Kinë në një mision të rëndësishëm diplomatik: po dërgon letrën e Shqipërisë për qëndrimin e saj ndaj ftesës që i ka bërë Kina presidentit amerikan Nikson për të vizituar Kinën. Në vend mbizotëron një lloj pezulli i përgjithshëm. Ndryshe nga romanet e tjera të Kadaresë, të cilët, zakonisht, kanë si tonus të përgjithshëm shiun dhe erën, këtu atmosfera është pezull. Ka kohë që pritet të bjerë shi, por ende nuk ka ardhur. Kjo gjendje pezulli përdoret si mjet stilistik jo vetëm për të vizatuar jetën jashtë, por edhe për të dhënë gjendjen e përgjithshme

8 Peter Morgan, KADARE – shkrimtari dhe diktatura (1957-1990), shtëpia botuese 55, Tiranë, 2011, f. 209-210.

9 <https://www.nytimes.com/1994/11/06/books/the-thrill-of-burning-bridges.html> "Koncerti është një vajtje-ardhje mes Shqipërisë dhe Kinës. Meqenëse z. Kadare përshkruan Kinën kryesisht përmes syve personazheve të tij shqiptare, kapitujt mbi Kinën janë më shumë impresive, sesa realiste. Megjithatë, z. Kadare, në fakt, e ka kaluar jetën e tij në një shtet policor komunist brutal. Llexuesi ka ndjeshmërinë që autori e njeh territorin e tij: impresionet e tij janë të qarta dhe ironia e tij, sado e tepruar që është, të bind."



1 <http://www.arkivalajmeve.com/Ambasada-Amerikane-nderpret-marredheniet-me-gazeten-Shekulli.1047022068/>

2 <https://www.straitstimes.com/eorld/chinese-video-journalist-who-disappeared-after-covering-wuhan-outbreak-tops-one-free-press>

shpirtërore. Jemi në një nga periudhat më të vështira të historisë së Shqipërisë në vitet e diktaturës. Janë vitet '78-'82 që finalizohen me vetëvrasjen e Mehmet Shehut.

Nis romani, pra, me limonin dhe me një festë familjare. Në darkën e ditëlindjes së Brikenës, Sajmiri, vëllai i Silvës, tankist, i thotë së motrës së ka rrezik që atë ta përjashtojnë nga Partia sepse ka thyer një urdhër ushtarak. Ndihet jehona e goditjeve në ushtri. Në qytet kishte kohë që përflitej zbehja e marrëdhënieve me Kinën. Besnik Struga, përkthyesi në romanin “Dimri i madh”, i pati treguar Silvës se si fishekzjarret e sjella nga Kina mbrëmjen e festës së parë pas prishjes me kinezët, shpërthyen me ca forma të frikshme në qiell. Një udhëtim në Kinë, një festë për ditëlindjen e Brikenës, vajzës së çiftit Dibra, Sajmiri që do të përjashtohet nga Partia, kujdesi për ta mbuluar limonin me një plastmasë, për ta ruajtur nga e ftohta dhe fishekzjarret në formën e gjarpërinjve me tri koka. Mbyllet kapitulli i parë.

Çdo fillim kapitulli nis me një përshkrim të natyrës dhe kozmosit. Qielli, aeroportet, satelitët, zogjtë që shtegtojnë, miliardat e sinjaleve që shkëmbejnë në ajër agjencitë dhe ja, Maoja i mbyllur në një shpellë.

Nis kapitulli i dytë.

Para kësaj, Kadareja, si mjeshtër i detajit të sjelljes formale me sens absurd ndonjëherë, i ironisë dhe satirës, na tregon një shenjë të kodit të komunikimit të shtetit kinez: renditja e anëtarëve të Byrosë Politike Kineze. Përmes kësaj renditjeje, pra, duke parë se kush ishte ngjitur apo kush kishte zbritur në renditjen e emrave që viheshin njëri pas tjetrit me protokoll politik, në një eveniment, ti duhet të kuptoje se ç’po ndodhte në Pekin. Maoja në shpellë dhe dy ministrat absurdë njëri që flinte mbi dy fuçi dhe hante vetëm barishte dhe tjetri që lidhte kokën me peshqir. Gjergji lart në ajër me çantën diplomatike dhe poshtë hapësira e pamatë e Kinës. Dhe atje, në atë hapësirë të pamatë, Kryetari Mao, i mbyllur në shpellë, mendohej të mësohej me jetën e asgjësë. Faqet që përshkruajnë atë në shpellë, janë të mbushura me absurdin e një diktatori paranojak që e ka kthyer veten në një mit:


“Të shkon ty të bësh një vizitë në çatinë e botës, i kishte thënë disa herë e shoqja. Të duhet. Ai kishte bërë shaka me të, e kishte quajtur vanitoze, por fshehurazi e mendonte vizitën...” (“Koncerti”, vep. e cit. f. 43). Pastaj letra dhe ekonomia shqiptare, ndërpreja e ndihmës. Me cinizëm, ai mendon se ky vend i vogël që merr ndihma nga ne, është zhytur në një jetë që ka një nivel të paktën dhjetë herë më të madh: apartamente, buzëkuq, vajzat dhe gratë ulen nëpër kafene, dritaret janë me perde, femrat hedhin parfum, në dyqane shiten romane (f.46). Është pikërisht ky oazë europeist që kishte vënë re dhe kritiku i censurës, që Kadareja e thekson me forcë në këtë roman. Atë vello moderne të jetës shqiptare, Kadareje e bën shenjë të Shqipërisë që duhet të shpëtonte nga indoktrinimi i komunizmit kinez.

Ka një pasazh në roman që flet për antropologjinë e marrëdhënieve të shqiptarëve me ata që e kanë pushtuar, por edhe me ata me të cilët ka qenë në marrëdhënie aleatësh. Ky pasazh shfaqet si një refleksion i Maos pasi ka lexuar letrën e shqiptarëve. Ata, në shekuj, e kishin ndier kënaqësinë e pushtetit, por jo atë në dy pëllëmbë vend, por në hapësirat euroaziatike, pastaj, kur kishin mbetur vetëm në dy pëllëmbë vend, të leckosur e të raskapitur, kishin kërkuar të kapeshin pas ndonjë fuqie të madhe.

“Kështu që grumbulli i donkishotëve, me kokën plot fantazma, por të rreckosur, filluan të kërkonin andej-këndej për të gjetur në mos një pushtues tjetër, së paku, një aleat të madh, me të cilin të bënin pak a shumë të njëjtën lojë. Domethënë, të hiqeshin si të varur prej tij e në të vërtetë ta shfytëzonin”. (Po aty, f. 50)

Këtë refleksion autori e ka vënë në mendjen e Maos, por ai ndihet më shumë edhe si një qortim i autorit për bashkëkombësit e tij, është një cen antropologjik i tyre. Maoja mbylli sytë ngadalë dhe autori thotë se ai është përfshirë në ëndrrën për ta kinezëruar Europën.

Kapitulli që pason, është një përshkrim i vanitetit të jetës në Tiranë. Kadareja është mjeshtër i ndërtimit dhe i rrëfimit të jetës qytetare. Elementet moderne të jetës së sotme si *show bizi*, apo bota e femrave dhe vaniteti i tyre tërheqës, Linda dhe Silva në zyrë, bisedat për gjërat e rëndomta të jetës, transformimi i një ngjarjeje politike në një *gossip* grash apo bisedë në kafene, deri të ndërhyrjet e autorit për të klasifikuar llojet e prishjeve me aleatët si dramatike dhe të qeta, apo identifikimi i brezave me ata që kishin lindur në kohën e bllokadës apo të tjerët që ishin formuar në kohën kur flitej se kinezët do të largoheshin. Kishte edhe më. Autori kujton edhe se si e kishte marrë vesh prishjen me jugosllavët: dikush hyri në klasën fillore e tha: *“Fëmijë, Tito tradhtoi!”* Dhe vjen pastaj një personazh që karakterizon një tip të njohur mirë në atë kohë, por që ngjet me burokratin e Gogolit, të Kafkës. Mishërimi i njeriut që humbet gjithçka nga vetja dhe riformatohet sipas kanoneve të burokracisë. Ai është Simon Dersha me kostumin blu që shfaqet vazhdimisht me



ankthin për të bërë një telefonatë. Nëpunës i nënshtuar, gati sa nuk mpihet nga ngazëllimi kur një miku i tij i thotë se do të shkojnë për darkë te një ministër. Ngazëllimi dhe pastaj shkatërrimi shpirtëror, sepse ministri qëllloi nga ata që do të quhej puçist, e zhyt atë në një pus të thellë faji. Kjo diagramë në personalitetin e Simonit të ndershëm, të urtë dhe parimor e dërgon këtë personazh në kufijtë qesharakë të absurdit. Ndjenja e fajit për një darkë të gabuar gati sa nuk e çon në vetëflijm. Ndërsa krejt në fillim, përjetimi i darkës te ministri dhe rikujtimi i saj ishte si një këngë me disa strofa që atë e fuste në ngashërim të ëmbël.

Absurdi i marrëdhënieve me kinezët ka një linjë të posaçme në roman. Viktor Hila largohet nga Tirana dhe gati përjashtohet nga puna sepse ka shkelur keq në këmbë kinezin Ping.

Ndërkaq, vazhdon misteri në Kinë dhe agjencitë e lajmeve e ato të hetimit nisin të shqyrtojnë përsëri renditjen e emrave të Byrosë Politike sipas një tjetër komisioni varrimi. E gjithë kjo vinte sepse askush nuk e dinte se çfarë kishte ndodhur me vrasjen e numrit dy të Kinës, Lin Biao. Rrëfimi i Kadaresë për këtë krim është i jashtëzakonshëm. Por, para kësaj, vizatimi i paranojave kineze të revolucionit kulturor kinez janë tragjike. Paralelet me Zeusin dhe Olimpin dhe lufta për shpëlarjen e trurit, plani për zhdukjen e librave dhe kthimin në nivelin kur ata kopjoheshin me dorë, t'i pritet krahu pianistit kinez që kishte luajtur Beethoven-in, zhdukja e dashurisë, shterimin e fantazisë dhe zhdukjen e artit. Kështu, revolucionit kulturor, sipas Kadaresë, synon të shkatërrojë vlerat perëndimore dhe rrënimin e Kinës e sheh jo si shkarje në Perëndim, por si rrëzim në obskurantizëm. Përballë saj, Shqipëria vështrohet si oazë europeist dhe model perëndimi.

Transferimi i ligjërimit

Ajo që ndodhi me numrin dy të Kinës, Lin Biao, jo vetëm që ka mbetur mister sot e kësaj dite, por, për nga mënyra e ekzekutimit dhe përmasat e efektit që shkaktoi, me të drejtë mund ta krahasosh me historinë e “Makbethit” të Shekspir. Në atë kohë, në një njoftim të thatë e të shkurtër, u tha se Lin Biaoja desh të arratiset dhe avioni me të cilin udhëtonte, u qëllua nga rojat kineze dhe ra në kufi me Mongolinë. Ndërsa Kadareja, me imagjinatën e jashtëzakonshme dhe me ndjeshmërinë e artistit të madh, e ka rindërtuar këtë skenë duke e përqasur me vrasjet në tragjedinë “Makbeth”. Sot, kur dëgjon lajmet për zhdukjen dhe shfaqjen e diktatorit koreano-verior Kim Yong Un, të shpaloset e gjithë narrativa e mbulimit të krimit nga diktaturat. Teksti që rindërtonte këtë skenë, është një tragjedi më vete brenda romanit. Çu En Lai, që vjen e i thotë Maos se ai po arratiset. Lëreni të ikë. Pastaj intriga me djalin dhe vajzën. Djali ishte nënkomandant i aviacionit kinez. Hipja në avion, pyetja fatale “Ku po shkojmë”, pastaj versioni tjetër i darkës. Ftesa për darkë familjarisht dhe pastaj vrasja e tyre dhe hipja në avion e kufomave. Në karkasën e avionit u gjetën shenja plumbash. Darka si te Makbethi. Në avion djali, gruaja dhe vajza që tradhton të atin. Ndërkaq, nëse e lexon me vëmendje këtë tekst, ti vëren se ligjërimi i përdorur këtu, është karakteristik për rrëfimin e ngjarjeve me sfond shqiptar më së shumti, sepse të gjitha skenat apo të gjitha detajet si dhe vizatimi i krimit ngjet

me rrëfimin për një ambient më së paku european. Shenja të tilla si darka, pastaj mbrëmja, lidhja e tyre me xhelozinë për pushtet, janë topika që vijnë më së shumti nga letërsia dhe nga mjedisi european e shqiptar, po ashtu. Kur e lexon, të krijohet përshtypja se po flitet për një ngjarje që ka ndodhur në një hapësirë që ti e njeh dhe që e identifikon me arealin ku ti jeton. Krimi, vrasja e bashkëpunëtorëve të ngushtë janë karakteristika për të gjitha diktaturat. Duke treguar vrasjen e Lin Biaos, Kadare nuk e dinte se vetëm pak muaj pasi ai e kishte dorëzuar këtë roman, numri dy i Shqipërisë, Mehmet Shehu do të vriste veten. Kjo kishte qenë një parandjenjë profetike, do të shkruante Peter Morgan. Edhe në këta rast kishte pasur një vizitë familjare, por në sens të kundërt: Enver Hoxha viziton Mehmet Shehun, pastaj një fejesë, një dashuri që sjell vdekje. Ndaj edhe censura që vendosi ndalimin e botimit të romanit, theksoi se nuk mund ta botojmë “në këtë situatë”.

Siç shkruante edhe kritiku amerikan, ky roman është një *va et vient - switches back and warth*, një vajtje-ardhje Tiranë-Pekin.

Gjergji është në Pekin, por që andej nuk vjen asnjë lajm dhe ne ndjekim jetën në Tiranë. Këtu, ndryshe nga romanet e tjera, nuk bie asnjëherë shi. Atmosfera është pezull, gjithmonë vrenjtur dhe të gjithë presin të bjerë shi. Silva kujton kohën kur është njohur me Gjergjin dhe letrën anonime për një flirt me Skënder Bermemën. Pastaj, në letër ishte shkruar që motrat e bukura Krasniqi ishin pak të çlirëta. Sjell ndërmend edhe Anën, motrën e vdekur, pastaj letërshkruesi anonim e hidhte fjalën për këmbimin e dashnoreve: Anë – Skënder Bermema, Silvë –Skënder Bermema, ndoshta... (f.147).

Rrëfimi alternohet. Gjergji jepet gjithnjë në ajër, në avion, me çantën e zezë që mban letrën sekrete. Poshtë tij është Kina, por edhe krimi, vrasja e Lin Biaos. Me anë të teknikës së transferimit të ligjërimit, autori vijon të tregojë aktet e tragjedisë. I duket se një mendim cinik kishte ndërtuar një skenë makabre. E doni? kishte thënë Maoja për sovjetikët. Merreni - dhe u kishte hedhur kufomën. Kështu edhe u përfol që Lin Biaoja donte të arratiset në B. Sovjetik.

“Tamam kështu, përsëriti me vete, ndërsa ndiente tëmthat t'i rrihnin me forcë nga shtypja e ajrit. Një histori hedhjeje kufome dhe asgjë tjetër. Në të vërtetë ishte një zakon i vjetër hedhja e kufomave brenda kështjellave armike, për të ngjallur terror. Nga historia i kujtohej hedhja në një gjyle topi e hirit të Dimitrit të Rremë të Rusisë në kufirin polak... Sovjetikët nuk kishin qenë më pak misteriozë me Berian e tyre. Kishin kaluar gati njëzet vjet dhe vdekja e tij kishte mbetur enigmë. Flitej se s'kishte pasur as gjyq, as skuadër pushkatimi, ngaqë e kishin vrarë më parë në mbledhjen e Byrosë Politike. Ca thoshin se e kishin mbytur me duar. Dhe kufomën e kishin futur pastaj në tokë. Kurse ky i çuditshmi Mao, kishte qejf t'i hidhte kufomat nga shteti në shtet si me hobë”. (f. 155).

Kujtoni këtu pushkatimet e Kim Yong Un me goditje me top apo pushkatimet dhe zhdukjen e kufomave te ne të atyre që u quajtën puçistë. I njëjti krim, e njëjta diktaturë. Lojë e dyfishtë e Kadaresë e ka quajtur Petër Morgan këtë cilësi të narrativës së Kadaresë që shkruante, siç thotë R. Kaplani, në një vend ku policia sekrete ishte ngado dhe përgjonte gjithçka. *(Vijon në numrin e ardhshëm)*



ËSHTË VONË PËR TË BESUAR ese nga Rexhep Ferri

1.

Lërinin lojërat e fjalëve!
Nuk jemi duke ditur çka po bëjmë.
Njeriu tani është robot i dirigjuar me telekomandë.
Unë nga koha e kaluar gjeta kohë të vazhdoj.
Është vonë për të besuar.
- Merre, ndize një cigare. Ulu. Prit. – koha, plagë dinake
më tha. – Mos shko më larg. Kurrë nuk ka pasur më shumë
maskara:
Për të qeshur.
Për të qarë.
Pritmëni!
Mos shkoni pa mua!...
Nga heshtja kemi mësuar shumëçka...
Gati e pabesueshme.
Nga mjegulla dhe legjendat gjithmonë më është dukur
se po notoj mbi valët e ujërave të panjohura.
Kur vjen një valë tjetër, për hesapet e një kohe tjetër,
edhe unë e qes një maskë.
Fillimet tona janë të largëta.
Koha e përshtatshme ka një lidhje planetare.
Njeriu ndoqi të veten.
Zoti nuk gjeti përgjigje.
Si do të veprojmë?
A ka histori?
Zemër...
Nuk e di.
Njeriu a mund të jetojë pa zemër...

2.

Kush po pret.
Kush po pyet!
Për nesër s'ka Zot!
Bukurshja e Fjetur është zgjuar pas tre mijë vjetëve.
Kjo legjendë ndoshta është edhe fati ynë.
Për hesapet e fatit, këto fillime shkojnë nga jeta deri
te përtej jeta...
Unë dhe Ai që doja të isha, sa herë kam dashur t'i
numëroj e t'i kujtoj vitet e kam harruar kohën me të cilën
po jetoj.
Kjo histori nuk shkon më larg...
Është vetëm një e kaluar.
Seriozisht më shqetëson.
Ne, shqiptarët e pesë shqiptarhaneve “jemi vend i
vogël, tepër i vogël edhe për ta gjetur në çdo hartë”.
Shikojeni diellin.
Duhet të më besoni.

Kur djalli e luan lojën, njeriu ndalet.
Qanë nga gëzimi...

3.

Përkuljes para zjarrit sot pakkush i beson.
Si më erdhi kjo ide e lashtë pagane nuk e di!...
Me vetminë e njeriut kam filluar të mësohem.
Jeta ka shumë të panjohura.
Pakkush e di.
Njeriu i ditëve tona e hoqi qafe besimin. Shpesh
largohet edhe nga mendimet e veta.
Një ëndërrues më pyeti:
- A keni çka të mbani mend?
- Nuk jam ai i atyre viteve kur i besoja njeriut. Tani
jam në kohën e provokimeve. Kush e kupton e kupton,
– i thashë.
Ai para se të largohet më tha:
- Lufta e pas lufta kanë shumë pazarxhinj. Edhe kur
jemi më të fortë se guri nga uria e nga lakmia e tradhtojmë
edhe Atdheun. A e di a nuk e di: paraja na pëlqen. Ajo na i
ngatërron mendimet dhe kërkesat. Mua edhe tani po më
kujtohet ajo ditë kur dikush dikujt i tha: “Merri paratë
e shko e vraje Hasan Prishtinën!” Kush e tha: përgjigjja
mbeti si krah i thyer.
Në përrallën për të jetuar.

4.

Nuk e kam të lehtë për ta kuptuar.
Krejt çka kërkon njeriu nuk e ka as deti...
Kam parë luftëra.
Por nuk po shoh njerëz.
Pas çdo çmendurie kend ta presim.
Një frikë e zezë, një trishtim i zi po më shqetëson.
Kjo frikë nuk është kaluese.
Ndoshta as unë nuk jam ai që isha.
Nuk e di sa jemi duke e kuptuar njëri-tjetrin.
Godoja i Beketit ka vdekur.
Humbjen kemi filluar ta kuptojmë.
Te guri kilometrik i Rrugës së Kombit u ndalëm për
t'i dorëzuar armët.
Njerëzve të dëshpëruar, ky realitet u erdhi si
poshtërim.
Jeta edhe si poshtërim më i madh.
Për ta kursyer fillimin, kurrë s'e kam menduar se
njeriu mund ta mbyllë ciklin e jetës me fajin e vet.
Kur era fryn e fryn, gjatë kësaj kthese edhe humbjen
kam filluar ta kuptoj.
Duke harruar se çdo gjë fillon me hapin e parë.
Në anën tjetër të kufirit, ku diplomacia politike,
përdoret për interesa personale, trishtimin po e lëmë
për nesër.
Qetësohuni!
Patriotët sojlinj i dinë rregullat.
Ylli më i bukur është i padukshëm.

5.

Kur të gjithë flasin kot flasin.
Sidoqoftë e kurdoqoftë, për mitin e njeriut do të
kërkojmë kohë shtesë.
Për të harruar historinë e shkruar e kam një sekret.
Kur vetja më duket lum, nisem për në hënë.
Vetes i kam premtuar dhe duhet të shkoj.
Po jo si i çmendur dhe jo për të qëndruar atje.
Të ulemi të pushojmë e ta pimë nga një gotë konjak
“Skenderbeg” e pastaj të dalim me shëtit vetëm.
Nga dielli dritën e kemi falas.
Kur presim më shumë se pak asnjë ëndërr nuk na del
ashtu siç e shohim.
Për vjedhjen e thesarit duhet ta pësim veten.
Tani nuk e kam asnjë pyetje, asnjë përgjigje.
Jeta na shkon duke ecur mbrapsht.
Për ëndrrat e kësaj bote, nga jeta e përtej jetës, zemër
zgjohu.
Mendova se ishte mirë, si është e mundur.
Më fal për dje, edhe në kushtet më të mira jetësore nuk
ka më rregulla për mirësjelljet njerëzore.

6.

Kur vjen një kohë e shkon një kohë.
Nuk e di pse kthehem e shkoj deri te koha që besohej
në shumë zotëra.
Deri te koha e Zeusit, që ka qenë kurvar i madh!...

Prandaj sot kemi shumë kopila pa babë.
Mos më keqkuptoni.
Nuk është as jetë, as vdekje.
E piu e zeza!
Duke vuajtur në vetmi historia nuk përsëritet.
As që duhet të përsëritet.
Edhe pse duhet të jetë njësoj, nuk e kuptojnë.
Për të gjitha këto humbje askush nuk e thotë të
vërtetën.
Histori, më shumë se histori.
Jo pse patëm fat dhe jo pse kërkojmë diçka që nuk e
dimë.
Legjenda vazhdon.
Edhe pse mund të jetë më mirë. Harrojeni historinë.
Kaq kot jetojmë...

7.

A e dini a nuk e dini, shkëlqimi i parasë shumëkujt ia
verboi sytë.
Në një tjetër kohë, me një tjetër frymë mbeta pa
mend e pa frymë.
Për të qenë më afër fushëpamjeve të mia, mendoj se
jeta ka shumë lumturi dhe shumë ndryshime.
As unë nuk e kam të lehtë për ta kuptuar.
Tani nuk kemi asgjë të paharruar.
Si do të vazhdohet nuk e di.
Ku ta gjej e ku ta shikoj të vërtetën, pritja më thotë:
Mos qaj!
Kemi ndryshuar.
Edhe shikimin, edhe kërkesat i kemi të ndryshuara.
Thjesht, nuk jemi të lumtur.
Edhe pse i kemi të gjitha për një jetë...
Përpara a ka qenë më vështirë, ka qenë.
A ka qenë më mirë, ka qenë.
Besonim njëri në tjetrin.
Thjesht: kishim me kë të flasim.
Me kë të bisedojmë.
Tani nuk e di as vetë për çka vuajmë.
Dhimbjet dhe urrejtjet i kemi të njëjta.

8.

Lëreni mirësjelljen!
Mirësjellja nuk është për ditët e kohës së tashme.
Të shkruhet se je budalla.
Duhet të ikim shpejt.
Duhet të jemi në kohë.
Tani e shikoj veten.
Më vjen keq.
Asnjë njeri që e njoh. Dhe, prapë shikoj.
- Zotëria juaj ku e ke hallin?- më pyeti një prostitutë.
– Çka po kërkon? Pse erdha unë?! A të shkojmë në një
funeral?
- Kush ka vdekur?
- Ka vdekur kush ka vdekur. Vështirë është për një
fillim. Kush është viktimitë?
Kjo pyetje pret dhe harron se çka pret.
Një kohë e harruar që tani më erdhi më tha:
“Dëshpërimi i pakuptueshëm të gjithëve po na bie në
sy! Si realitet e kemi shumë të vështirë ta pranojmë”.

9.

Patriotët tanë mashtrues nuk pushojnë.
Flasin.
Premtojnë.
E, në anën tjetër vazhdojnë rrugën vetëm për interesat
e tyre personale.
Me vite e vite thesarit kombëtar ia kanë lodruar nënën.
Për rolin e historisë, mbijetesa është në krizë.
Na duhet prapë të mësojmë nga historia e pashkruar.
Nga miku dhe armiku, vonesa po na kushton.
Dëshpërimi po na çon në shkretëtirë.
Për ta parë Hënë e shkretëtirës.
Në shkretëtirë Hëna shihet si mbretëreshë.
Vazhdon rrugën.
Shkon e prapë kthehet.
Në shkretëtirë çdo gjë është më e madhe se realiteti.
Shfrytëzoheni këtë fat.
Patriotët hileqar nuk kanë turp.
Nuk kanë as fytyrë, sepse nuk janë kurrkushi.
Me famën e tyre të rrejshme na është acaruar jeta.
Në këtë pike, vizë, pikë, ka shumëçka të çuditshme.
Helmuese.
Në të dyja anët humbje e tmerrshme.

TRE TREGIME

nga

Agron Tufa

DITA TJETËR PAS VDEKJES

Ishte krijesa ime. I bukur. I bardhë. Sykaltër. Si i ati. Për të rroja. Për të merrja frymë. Për të duroja punën e kuajve, sharjet e policëve, ngacmimet e kapterëve, etjen, urinë, braktisjen. Pjetri im i vogël! Ishte 3 vjeç kur u sëmur. As doktor, as ilaçe... Të paktën të më linin t'i rrija te kryet. Tan ditën e lume me trupin në mal e mendjen te djali. Si ta parandjeja, atë ditë, duke hyrë në pyll, bëra përpjekjen e mbrame, të dëshpëruar. Iu luta kapterit të më linte të kthehesha te djali. "N'dorën tande, zotni...". Ai më kqyri si t'më kishte pritë gjatë t'i bija atij shtegu. Mandej treti vështrimin diku larg.

- E sheh atë njollën jeshile, buzë përroi?
- Shkurret e gjineshtres?
- Po, - tundi kokën. - Shko hyr midis shkurresh dhe më prit... Të të gjej të zhveshur! - tha, me ton urdhërues.

- Unë e kam një burrë, zotni... Nuk due me njoftë burrë tjetër, sa asht gjallë ai.

- Ashtu? Një burrë kriminel! Po ku e ke? Ty po të vdes djali! Si të duash, - tha dhe ktheu shpinën.

Parandjenja se nuk do ta gjeja gjallë tim bir u vërtetua sapo shkela në kamp. E shtrëngova në gji kurmin e tij të ftohur, duke qarë pa zë, e rrethuar me plakatzemërmira. Dha shpirt loçka e vogël pa nanën e vet pranë. Ku shkojnë vallë këta shpirttra të pafajshëm, pa u ngopë kurrë me nanat e tyre? E ndieja se shpirti i tim biri endej aty, përrëth meje, në kazermë. E varrosëm po atë natë. Me fenerë. Kur ra bilbili i zgjimit të nesërmen, në orën 5.00, isha mbledhë krupull nga dhimbja: as në ëndërr, as në zhgëndërr. Në fakt, po kuvendoja me shpirtin e Pjetrit tim të vogël.

- Po ti, qelbësirë reaksionare?! Pse s'del në rresht? Tund e shkund krevatin si i çartur.

- I ka dekë djali, mor kapter..., - provoi të ndërhyjë plaka përbri, por ai e ndërpreu vrazhdë:

- Mirë ka bërë! Bir kriminel i ka vdekur.

U ngrita ashtu, e mpirë, somnambul, në rresht për punë...

VARRI I DYQINDTË

Jam varrmihësi i kampit. 14 vjeç. Ma ngarkuan këtë punë si më i madhi, që në Turan. Për një copë bukë misri më shumë. Një varr - një copë bukë misri. Shpesh e papjekur; shpesh me miell të ndezur. Villja, në fillim. Gjysmën e ha vetë, gjysmën ia ruaj mamës dhe motrës së vogël.

Sot është ditë e shënuar: hapa varrin e dyqindtë. Po pushoj buzë varrit të hapur, por ende s'ka vdekur njeri. Polici më urdhëron t'i hap. Deri në mbrëmje dikush do të vdesë. E sigurtë. E shumta, deri në mëngjes.

"Varri duhet të jetë gati", - thotë polici, "se ju, reaksionarët, nuk e deklaroni të vdekurin, që të merrni një copë bukë më shumë". "Ju", - thotë ai, - "edhe me të vdekurit tuaj, kërkoni ta dëmtoni pushtetin popullor".

Por unë e pyes kot, kinse për përmasat e varrit:

- Për kë e kam hapur këtë varr zotni polic?
- Për surratin tënd, reaksionar, - ma kthen.

Ani. E marr si shaka. Përreth varrit të sapohapur vërtiten kalamajtë. Vajzat kureshtare pyesin:

- Po tesh, more, kush ka dekë?
Hidhem në gropë dhe shtrihem.
- Kqyreni, e kam bënë bukur, a? Si për vete...
- Uuuuuuu! Ça ban mor ashtu? De, mor, se asht keq!
Në buzët e varrit mblidhen trumba kalamajsh të habitur. Bërtasin:

- Ngrehu, ngrehu, se erdh roja! Erdh polici e tesh po t'myt ndru!

- Ani, - u them, po s'luaj vendit.

Rrethi i kalamajve largohet dhe unë hap sytë: në teh të gropës, përballë, njëmend shoh policin. Dalloj kuartë se si i dridhen mustaqet prej tërbimi. Marr të ngrihem, por ai bën shenjë me dorën e majtë:

- Rri aty, mos lëviz!

Heq pushkën prej supit dhe më merr shenjë. "Shaka do të jetë", mendoj dhe e ndjek krejt i qetë, pa treguar asnjë grimë frike. Deri në grimën kur papritmas buçet krisma.

Britmat e fëmijëve përreth sa vijnë e shuhen, shurdhohen. Mbetet vetëm mendimi i mbamë, me të cilin shkrihem njësh me dheun e freskët, që njomet nën brinjë: i dyqindti...

PALLTO BLU ME KATRORE TË BARDHË

Stofin na e dërgoi nga Vjena një mik i tim eti. Ishte një blu-saks i ëmbël me katrorë të bardhë. Prej copës dolën dy pallto, një e madhe, për babin, dhe një e vogël, për mua. I veshëm. Sa bukur na binin! Dolëm të dy shëtitje. Pasdarke i bëmë bashkë detyrat. Mandej më mori gjumi.

U zgjova në mesnatë prej ca zhurmash e rrapëllimash periodike, sikur diçka shembej, vithisej periodikisht. Hap sytë me vështirësi dhe shoh mes njerëzve të shtëpisë uniforma oficerësh të Sigurimit. Fytyrën e njërit prej tyre, me sytë me rrathë, që me gjasë qenka dhe shefi, se ku e kisha parë...

- Fli, bir i babit... Kthehu nga ana tjetër, - më thotë dhe më ndihmon të kthehem me fytyrë nga muri. - Thjesht një sqarim kanë, - shton me të butë, pasi jam

kthyeu nga muri. Dhe njëmend: i ndjeva kur dolën në korridor, kur zbritën në shkallë, në oborr... e fundit u largua dhe zhurma e makinës.

- Ku është babi, - pyeta fill pas zgjimit gjyshen e krupullosur në minder.

- E morën mbrëmë, - tha ajo. - Po ti mos u merakos, xhan, shko në shkollë... kur të kthehesh, babin do ta gjesht në shtëpi.

Po im atë nuk u kthye atë natë. As të nesërmen.

Në shtëpi hynin e dilnin thuajse hajdutçe dy-tre njerëzit më të afërm të farefisit. Mami u bë thuajse memece. Nuk fliste. Mezi belbëzonte me të mëdhenjtë. E ndjeva se diç e rëndë dhe e keqe po na ndodhte. Këtë, si duket, e kishte nuhatur edhe motra ime 3 vjeçare, ngase ajo, papritmas, iu ngjit mamit pas fustani dhe kurrë më nuk e lëshoi.

Të pasnesërmen veshja pallton, por nuk shkova në shkollë. Ia mbajta drejt burgut të Tiranës. Pikërisht gjatë rrugës për tek Selvia ku gjendej burgu, më ra ndërmend se ku e kisha parë shefin e atyre oficerëve të sigurimit që morën babin në mesnatë. Fytyrën e tij e kisha parë para një jave. Hyri në shtëpinë tonë me dy djem të tjerë, të gjithë me kostume. Tha se donin të kontrollonin muret e banesës sonë, mos kanë ndonjë plasaritje. Tha se po i kontrollonin të gjitha banesat e vjetra ngase pritej të binte një tërmet i madh e i fuqishëm.

Ndërkohë kisha hyrë në oborr dhe një polic më çoi drejt një zyre në katin e parë.

- Kë kërkon ti, shok, - më pyeti në zyrën e tij oficeri i rojes me një shirit të kuq në parakrah.

- Tim atë, - thashë, - Manush P. E morën parmbrëmë në mesnatë për të sqaruar diçka dhe nuk është kthyer... A ndodhet këtu?

- Prit pak, - tha dhe u lidh me dikë në telefon.

E pyeti për tim atë. Pastaj një copë herë dëgjoi zërin nga ana tjetër, të cilin e shoqëroi me një varg gjatë "ëhë, ëhë-ëhës-shë". Pastaj uli telefonin dhe tha:

- Shok, shko dil e prit në oborr. Do merret informacion e do t'ju komunikohet.

Dola. Kalonin orët. Asnjë përgjigje. Befas pashë të dilte me vrull në oborr pallton e gjatë të tim eti. Më brofi zemra si e çakërdisur. Thirra fort:

- Babi! Baaabiiii!

Çudi! Nuk e ktheu kokën derisa iu afrua derës së hapur të një xhipi të zi. Hyri në makinë dhe, para se të mbyllte derën me xhama të errët, kreu kokën. Mandej uli dhe xhamin e xhipit dhe m'i kalli në distancë sytë e tij me rrathë. Shtanga. Ishte fytyra e shefit të Sigurimit, ai që pati ardhur të kontrollonte banesën tonë, e më pas, ai që mori babin në mesnatë.

Pse vallë ai mbante pallton e tim eti?

Kur arrita në shtëpi, më përqaftuan dhe qanë. S'kishte nevojë për fjalë.

- Kur? - pyeta i tronditur.

- Mbrëmë, në mesnatë... bashkë me 21 të tjerë...

Diç e pezullt më mbeti në grykë, që atë ditë, - një lëmsh i pazgjidhur, që më torturon ende, - sa herë ndesh burra me pallto blu me katrorë të bardhë...



METAFORA

poezi nga

Giuseppe Schirò Di Maggio

...01

Evropa me mijëra ngjyra
Evropa e kufijve të hapur
Evropa e gjuhëve
Evropa e bankave
Evropa e së ardhmes
do të vijë edhe këtu.
Mikpritës i përpiktë,
do të veshësh tët bijë
me kostumin tradicional
e do ta dërgosh në sheshin kryesor
me kanistrën më të re
t'i dhurojë Evropës
sa toka jote prodhon:
vaj verë djathëra.
Nuk mund t'i dhurojë,
vajza jote e pafajshme,
shenjën e dallimit tënd më të lashtë
fjalën arbëreshe
të bjerrë dhuratë të shpirtit.

...02

- Mos u nis kaq shpejt, vëlla,
s' më jep as edhe kohën
të të shtroj bukë e verë
të të flas për jetën time
për vetminë time e për psenë.
Mos rrimë këtu te dera.
Mos u tremb të hysh.
E di se mund të t' dukem si trau i sprasëm
i një argshi të vjetër tani mbërthyer
nga bunaca e pandjeshme
e këtij oqean-homologimi,
por çdo t'i bën? Mundet në realitet
të bëhet ndonjë gjë?
Ngushëllimi i pranisë sate - unë e di -
do të më rëndojë më shumë vetminë
që do të pasojë mënjëherë nisjen tënde.
Vetmisë pra do t'i shtoj vetmi.
Zinxhiri im.
Pastaj më qëndron po të mbyllem në vetvete
me shoqërinë e pakëndshme
të regëtimës mekanike të orëve.

...03

Më deh. Ka gradë alkolike të larta
kjo mirpritje jote.
Gjaku i tokës sate. Transfuzion.
Unë këtë verë të pagëzuar
me dashuri vëllazërore
nuk e mbaj mirë!
Tryeza e shtruar. Buka që gjeshe ti
por lulet e fjalëve
kundërmojnë më fort se rigoni.
Qesh. Më thua se sekretin e jetëgjatësisë
e ruan në shpellat e tua - barkushe të zemrës.
Unë s' di ç' të të them.
S'mund të flitet me objektivitetin e verës.
Por dy fjalë duhet t'i vë në tryezë.
Jam i sigurt se asgjë e asnjëri
s' mund të të ndërrojë
gjer që në kurmin tënd do të qarkullojë
limfa arbëreshe që të përcakton!

...04

E di, mos ki merak!
S' ke nevojë të kuqesh!
Kjo botë jona nuk është
bota e çudirave!
Një ditë të erdhi turp
për veten tënde e për fjalët e tua
dhe lipe shkurorëzim nga gjuha jote e parë!
Një perëndi fitimtare veptoi mbi ty shndërrimin
e sot ke vetëm gjuhën tënde të dytë.
Mund të mburresh me kaq për ndonjë
pikë qëndrese:
ca pleq belbëzojnë akoma
ndonjë shprehje të gjuhës së parë!
Por rri në pritë - ka qënë përherë në pritë -
furtuna e tmerrshme e asaj perëndie fitimtare:
një vrundull më të vendosur
e as dhe pleqtë s' do të të qëndrojnë më.
Por ti mos ki merak!

...05

Vendose male të gjalla si mure për mbrojtje
e humnera të pakapshme ku me vrull
rrjedhin ujëra luftëtare pengesa
kundër hyrjes së armiqve. Por armiku
i sotëm televiziv që nuk mundi
nga toka të vijë, me dhunë hyri
nga ajri o nëpërmjet kabllor e tani
është mysafir i përhershëm i gostive
dhe i festave të tua. Por kush gërryen pak
ngjyrën e jashtme të shtëpive të tua
zbulon zemrën tënde të kuqe arbëreshe
e kush fshin pluhurin nga gurët e tu rrugorë
ndien kumbimin e valleve akoma
për të dashurën tënde të lashtë.

...06

Qëndrove në moshën tënde të re
dhe as ke nevojë të fshehësh vitet:
me siguri të ruajtje kështu
dashuria dhe dëshira e atyre që të vinin rrotull.
Qëndrove besnike në parimet e dëlirësisë
edhe në kohë në të cilat
të shkëshillohej të ndodheshe e vetme.
Mund të vazhdosh ashtu për mot e monë.
Por trembem se mos të të paraqitet
nga rruga kryesore - në një mesditë
plot diell të hutuar -
ndonjë lajkatar magjepsës
që të rrëmben me turbomakinën e kuqe-flakë
- volumin e stereos të gjithë-ngritur
që mbyth thirrmat e tua të kota.

...07

E di se të jap zymtësi kur të flas
për sëmundjet e tua
e se duhet të të vërejë jatroi
- një "TAK", një "çek ap", analizë e gjakut
e urinave dhe e ndo gjëje tjetër -
se duhet të mbash
- por e ke mbajtur prej kohësh,
sidomos kur s' kishe gjë tjetër të mbaje -
dietën mesdetare
se duhet të bësh lëvizje
t'i shmangesh stresit të jetës moderne!
Rreziku është serioz
sepse ke mundësi të zhytesh
në një përjetësi heshtjesh
ku as edhe heshtja ndihet,
ti që mund të shpëtohesh
ngase akoma e largët është fusha
që bën të rrafshë çdo gjë që prek.

...08

Të gjej të vetme në këtë pyll lisash
plot me druajtje nga ankthet që nata
të derdh më tepër se çdo nxënësie të mundshme
e nga vegimet e tmerrshme që dita
të bën të të kërcejnë përpara.
Më thua me pikëllim se ke humbur
edhe ngërdheshjen e pavullnetshme
të buzëqeshjes së hidhët.
Brenda pyllit edhe dielli është i rremë
dielli që të ndërton shkallë drite
- të çahen në duar nëse i prek -
e që kurrë s' mund të të ndihmojnë
të ikësh nga lëmshet e nënpyllit.
Por në vonon akoma princi yt shpëtues
do ta gjejë krejt të ngurosur kurmin-tënd-lis
me copa veshjeje të ngjitura
si flamur disfate.



...09

Poeti* ynë vdiq gjatë rrugëve shtetërore
mbi shtroja hekurishtesh të përdredhura
me vegime botësh të shajnitura. Megjithatë
shpresa o e ardhmja s' mund të ketë
kundërmim benzine përzier me gjak
por fryme të mirë njeriu
që do të të trashëgojë brez pas brezit
me të folmen tënde tipike.

* Poeti Vorea Ujko, papas Donenico Bellizzi, lindur në Frashnitë në 12.6.1918, famullitar i Fermës për 46 vjet, vdiq, pas një aksidenti automobilistik, në Bari më 24.1.1989.

...10

Horizonti yt detar është Joni
i pjellë nga ujërat e tua amniotike
i pagëzuar me lotët e tu
të fortë kripe.


Mbi ankthin tënd të rindërtuar
ngrite ballkone të reja të vëzhgoje
horizontet e kuqe deti
që lindja në agim të bie.
- Kur m'u çajten ujërat
ishte stinë e mesme - më thua -
e të lindurit e mi shpejt morën
rrugët tokësore të mërgimit
ashtu që sot druaj
pranverat dhe vjeshtat stinë
në të cilat bijve që më qëndruan
zakonisht u zgjohen
dëshira dashurie të jashtme.

...11

Tokë kufitare.
Shoh se jeton
jetë të shumta në përzjerje.
Shoh se si kunj në mish
ke botën e autorrugëve
me flamujt dhe mitet e tyre.
Botë fitimtare kjo!
Ndoshta do ta paguash me çmim të lartë
rreshtimin tënd me kohët.
Të uroj të mos qëndrosh më vonë
si plakë e çmendur
që me ndihmën e duarve
u trashëgon gjërave të pashpirta
fjali të pakuptueshme
ndërsa uturima e motorëve
e mbulon të tërë
dhe gjestet e saj duken
gjuhë shurdhmemeci.
Ribëj llogaritë, të lutem.

...12

Në pragun e këtyre shtëpive
të zbardhura me ngyrat e jugut,
të gjej ulur
ndrikull e tërhequr nga fjalët.
Natyra jote është prej mishi dhe guri
- guri më i qëndrueshëm se mishi.
Ashtu ke parë e ke dëgjuar
me qenien tënde prej guri të qëndrueshëm
e ke vuajtur dhe pasur gëzime
me zemrën tënde mishi
trashëgim të çdo brezi.
Mishit i përket pasiguria e së tashmes
gurit qëndresa e këmbëngulja.
Përsiatje nga mësimet e jetës!
Por shpërthejnë papritur
thirrma lirie:
nipat e tu kthehen nga shkolla
në këtë orë mesdite.
Të uroj t'i shohësh të kthehen



ndonjë ditë e pra përditë
me çantën plot ushtrirme arbëreshe!

...13

- Veprat arkitektonike më të bukura,
veprat artistike me nam shekullor
... "Sheshi Shën Marko"
"Kambanari i Xhotos"
"Kulla e pjerrët e Pizës"
"Xhokonda e Leonardos"
"Moisiu i Mikelanxhelos"
"Kapela Sistina"...
janë për mua, që s' kam vepra monumentale
t'u nxjerr para turistëve,
gjuha ime!
gjuhë e prerë e përçmuar
e ndotur e copëtuar
e thartuar me të mbeturat e shpendëve
si monument i lënë pas dore
e nxirë me smog
në rrezik të vazhdueshëm të prishet
por megjithatë
vepra ime arkitektonike më e bukur
kryevepra artistike e qytetërimit tim!

...14

Duart e stinëve të kanë dhënë formë
të ngjashme me kohën dhe ti
të kohës sjell rrudhat e jashtme
por mban ende shpirtin djalë
ashtu si përjetësia ta dha:
është kjo vetëdija që nuk ke humbur.
Kështu i ke bërë ballë dredhive të thurura
nga bijtë e shumtë të kohës: minutat orët ditët
muajt vitet shekujt. Koha jote armike,
së cilës gjatë luftimit
çdoherë i lë një rreckë prej teje!
Por s' ka rëndësi për ty mplakja - besoj -
nëse akoma të duan këta djem e këto vajza
të dalë somenatë
nga një lindje e gëzuar pranvere.

...15

Me përendinë tënde të dhënë të mundur
nga breza bastvënësish
këtu ti mbahesh fort në garën e mbijetesës.
Ke lëkurë të trashë të regjur

nga pesëqind dimra e pesëqind vera.
Po të duash mund t'i bësh ballë edhe
qytetërimit gërryes të acideve.
Po të duash mund të dëftosh
mburojat e tua shekullore: Koroniatët e tu.
Po të duash mund të shpëtohesh
nga valët herciane elektromagnetike
të shkurtra të gjata të mesme,
pa vatur prapa në mesjetë.
Duhet se edhe ne të modernizohemi
me valë herciane elektromagnetike!
Por le të ta them hapur:
sot më jep gëzim të di
se nimfat arbëreshe nuk kanë ikur
nga pyjet e tua e se akoma
i ngjeshin ijët me ujërat e përrenjve.

...16

- Nuk të them për dhëmbët e mi
të çarë me përkëdhelje të rënda
- vëri në hesapin e një sasive shekujsh -
as për torturat për të mohuar shpirtin
as për shpëlarjen e trurit që të ndërroja mendje
as për provat të më shkulinin gjuhën.
Ku mund t'i bëja ballë i bëra ballë;
ku pat të lija - natyra ime njeriu
ma lejonte - lashë.
Të them vetëm se në sot mund të të flas
me gjuhën që tani dëgjon, do të thotë
se mbi gjënë më të rëndësishme nuk u nënshtrova:
mbi të drejtën të kem fjalën time.

...17

Do të zgjohesh
me të parën qarje të ndërgjegjes sate
dhe syhapur do të kërkosh
horizontin tënd të humbur.
Do të vishesh pra me fjalët e tua
e me ndjenjat e tua do të rindërtosh
zjarret e mençurisë sate.
Edhe së largu do të duket zgjimi yt.
Ndoshta do të jesh pastaj në gjendje
t'u bësh ballë goditjeve të erës
- vënë si je përpara syve të fushës -
e ndoshta s' do të druash
përqafimet plot gjumë të reve
që vijnë nga të katër anët e botës.

KRISTO FLOQI, KOHA DHE VEPRA E TIJ LETRARE

Prof. As. Dr. JONELA SPAHO



Jonela Spaho ka lindur dhe jeton në Korçë dhe punon si pedagoge e letërsisë në Universitetin “Fan S. Noli” të këtij qyteti. Ajo është diplomuar në Universitetin e Tiranës në Fakultetin Histori-Filologji, në degën Gjuhë-Letërsi dhe mban titullin Profesor i asociuar.

Detyra që qëndron para kujdo kur i hyn punës për të shkruar për një autor a çështje të caktuar, është të japë një sintezë të asaj që është arritur në këtë fushë studimi, për të kuptuar se në çdrejtime do ta shpjerë më përpara ai mendimin shkencor në fushën përkatëse. Por në rastin kur objekt studimi është një autor që pjesa më e madhe e krijimtarisë së tij letrare i përket gjinisë dramaturgjike, puna qëndron disi më ndryshe: horizonti i pritjes së veprës së një dramaturgu dhe komediografi nuk ka lidhje vetëm me kritikën, për tekstin e botuar, por dhe me skenën. Prandaj në këtë punim për veprën letrare të Kristo Floqit, historia e studimit do të përfshijë si pritjen nga mendimi kritik e historiko-letrar të tekstit të veprave të tij, por dhe pritjen nga spektatori e kritika të spektaklit të veprave të të tij.

Është një fakt që duhet pohuar që në krye se horizonti i pritjes për krijimtarinë dramaturgjike të Kristo Floqit ka qenë më i ndjeshëm ndaj shfaqjeve në skenë të veprave të tij, se sa ndaj tyre si tekst letrar. Në këtë aspekt është është e përligjur vëmendja që do t'i kushtojmë më poshtë pikërisht këtij aspekti të pritjes së veprës së këtij autori, kryesisht asaj dramaturgjike

Kristo Floqi është pa dyshim një nga autorët më popullorë të letërsisë e veçanërisht dramaturgisë shqiptare në periudhën 1912-1939. Vepra e tij juridike, politike, publicistike dhe sidomos ajo letrare ka qenë e njohur gjerësisht në periudhën kur ai e shkroi atë, ndërsa pas Luftës së Dytë Botërore, emri i tij gati u harrua ose u përmend shkarazi në ndonjë tekst të Historisë së Letërsisë Shqipe apo studim kritik.

Ky punim kërkon të ndriçojë aspekte të rëndësishme të jetës dhe krijimtarisë së këtij autori, pak të njohur dhe shumë pak të studiuar për një periudhë, gati gjysmëshekullore. Emri dhe vepra e tij u la gjatë në heshtje, ndërsa sot ka ardhur koha që ky autor me këtë krijimtari të begatë, veçanërisht në një gjini pak të zhvilluar në letërsinë tonë në periudhën kur shkroi, të zërë vendin që i takon në radhën e autorëve të traditës që sollën kontributin e tyre duke pasuruar letrat shqipe.

Duke qenë një figurë e spikatur jo vetëm në aspektin letrar dhe publicistik, por dhe politik, emri i Kristo Floqit është përmendur e analizuar në shumë organe të shtypit të kohës, kur ai dominoi në jetën politike dhe shoqërore.

Fisnik në pamje, erudit në kulturën e tij, një personalitet poliedrik me botëkuptim të formuar nën ndikimin e disa kulturave, burrë i vërtetë shteti, orator dhe organizator i përkryer, ai i bënte vend vetes në të gjitha mjediset, shoqëritë dhe vendet ku ai jetoi pjesën më dinamike të jetës së tij. Duke pasur një aktivitet të rëndësishëm politik dhe patriotik dhe një gjeografi të pasur vendndodhjesh, emri i tij do të përmendet e analizohet në organe të tilla si “*Dielli*” i Bostonit, “*Dielli e Flamuri*” Boston, “*Atdheu*” Kostancë, “*Shtypi*” Tiranë, “*Gazeta e re*” Tiranë, “*Demokracia*” Gjirokastrë, “*Kalendari Kombiar*” Sofje, “*Posta e Shqypnisë*” Shkodër, “*Populli*” Vlorë, “*Besa shqiptare*” Shkodër, “*Gazeta e Korçës*” etj., në të cilat analizohet jeta dhe aktiviteti i tij politik në periudha të ndryshme.

Por ajo që na intereson më tepër në këtë studim është vepra e tij letrare e më konkretisht ajo dramaturgjike.

Siç e thamë, ai botoi një numër të konsiderueshëm komedish dhe dramash, të cilat publiku i ndoqi me kënaqësi në skenat e teatrove amatore dhe kritika vuri në dukje suksesin e tyre. Kështu përmendim “*Argëtim theatruet i tretë në Elbasan*”, “Posta e Shqypnisë” 1918, “*Fe e kombësi luhet në Korçë*”, “Gazeta e Korçës” 1920, “*Theatroja* “*Fe e kombësi*”, “Koha” Korçë, “*Bisedime teatrore*”, “Ora” Tiranë, “*Mbi komedinë e Kristo Floqit*”, “Gazeta e Korçës” etj. Po ashtu analiza mbi vepra të veçanta të tij janë bërë në “*Gazeta shqiptare*” Bari, 1935, “*Besa*” Tiranë, 1935, “*Letra*” Shkodër 1935, “*Ora*” Tiranë, 1921 etj.

Pas shpalljes së Pavarësisë, në vitin 1912, me krijimin e shtetit të ri shqiptar, lëvizja teatrore amatore filloi të përhapej në gjithë vendin. U ngritën një numër i madh grupesh amatore në disa qytete të Shqipërisë si Korçë, Shkodër, Berat, Vlorë, Tiranë etj, të cilat vunë në skenë shumë pjesë të shkruara nga autorë shqiptarë. Me gjithë kushtet e vështira që hasnin këto trupa amatore si dekor, skena, përgatitja e aktorëve etj, pasioni dhe dëshira e mirë e themeluesve dhe anëtarëve të tyre, bëri që këto teatro amatore të zhvillonin një aktivitet të dendur artistik.

Në periudhën në fjalë, Korça dhe Shkodra ishin dy qytetet që kryesonin në aspektin e aktivitetit teatral. Studiuesi J. Papagjoni te “Teatri dhe Kinematografia shqiptare”, i cilëson këto dy qytete si qendra të rëndësishme të teatrit shqiptar deri në vitin 1945, duke u ndalur hollësisht në aktivitetin e tyre teatral.¹ Në Korçë, në këtë periudhë do të zhvillonin aktivitetin e tyre disa shoqëri artistike, të cilat vunë në skenë një numër të konsiderueshëm pjesësh dramaturgjike, kryesisht krijime të autorëve korçarë. Ndër këto shoqëri si më të rëndësishmet përmendim “Banda Vatra”, formuar në SHBA, nga patriotë shqiptarë. Nga anëtarët e saj dhe nga të rinj shqiptarë të ardhur nga Rumania, për mbrojtjen e atdheut, u krijua në vitin 1920 “Shoqëria e Arteve të Bukura, e cila zhvilloi një aktivitet të gjerë artistik, muzikor dhe teatror. Në vitin 1925, u krijua shoqëria artistike “Djelmëria Korçare”. Më 1926, nga “Shoqëria e Arteve të Bukura”, u krijua “Grupi Dramatik”, që synoi t’i jepte shpirt dhe gjallëri artit në Korçë. Më 1927 u krijua “Klubi Sportiv e Artistik”, ndërsa më pas, në vitet 30’ u krijuan shoqëritë “Puna”, “Rinia Korçare”, etj, të cilat në aktivitetin e tyre kulturor e patriotik, përfshinë dhe vënien në skenë të shumë pjesëve teatrale.

Siç e përmendëm dhe sipër, po të vërejmë më kujdes repertorin e skenës së kësaj periudhe, vëmë re se si material skenik, kryesisht është shfrytëzuar prodhimtaria e autorëve shqiptarë dhe në një masë të konsiderueshme janë vënë në skenë edhe pjesë të huaja. Fakti që skenat teatrore, jo vetëm në Korçë por dhe në qytete të tjera të Shqipërisë preferuan krijimtarinë e autorëve shqiptarë vjen për disa arsye:

Së pari, këta autorë pjesët e të cilëve u vunë në skenë, ishin autorë bashkëkohës, njerëz të arsimuar dhe me kulturë të gjerë të marrë në perëndim, të cilët e njihnin mirë psikologjinë, temperamentin dhe mënyrën e jetesë së publikut shqiptar, ndaj në krijimtarinë e tyre ata u përpoqën të pasqyronin kryesisht mentalitetin e kohës.

Së dyti, duke ditur që gjendja e teatrit të kohës kishte plot dobësi dhe mungesa, si nga ana aktoriale, ashtu dhe ajo skenike, pjesët e autorëve shqiptarë ishin më të thjeshta për t’u vënë në skenë, si nga ana e dekorit ashtu dhe nga numri i personazheve.

Së treti, këta autorë i krijonin kryesisht këto pjesë të diktuar nga mungesa e materialit skenik, ndaj ato që në fillim ishin të destinuara të bënin jetë përmes skenës.

Së katërti, veprat dramaturgjike të autorëve shqiptarë kishin një frymë të thellë patriotizmi dhe atdhedashurie, çka përcillte mesazhe të fuqishme ne auditorin mbarë shqiptar të asaj kohe.

Vlen për t’u theksuar fakti se duke vërejtur repertoret e teatrove në qytetet kryesore të Shqipërisë, (atje dhe ku u zhvillua lëvizja teatrore) emri i Kristo Floqit qëndron në krye të listës. Dhe kjo vërteton dhe njëherë faktin se pjesët e tij skenike, me mesazhet që ato përcillnin dhe lehtësinë skenike që paraqisnin, u preferuan në masë të gjerë nga pothuaj gjithë trupat e teatrove amatorë në Shqipëri.

Edhe shtypi i kohës i pasqyroi sukseset e komedive dhe dramave të Kristo Floqit. Kështu te “Gazeta e Korçës”, më 21 korrik të vitit 1920, jepet njoftimi mbi shfaqjen e dramës “

¹ J. Papagjoni, Enciklopedia Teatri dhe Kinematografia shqiptare, Tiranë, 2009.

Fe e kombësi”, e midis të tjerash thuhet: “*Banda kombëtare “Vatra” do të lozë të Premten dhe të Djelë mbrëmanet, 23, 24 korrik, më 8, në Gazino, dramën e famëshme “ Fe e kombësi”. Kjo vepër është shkruar në vjershë prej atdhetarit tonë të dëgjuar, z. Kristo Floqi. Në të tregohet çkoqur feja dhe kombësija e shqiptarit dhe i jep mundësi shikonjësit të kuptojë mirë qëllimin e shkrimtarit dhe i tregon që në çështje kombëtare dhe dashurie s’ka të bëjnë fare feja. Blini tiketa të gjithë, që të shikoni një dramë nga më të rrallat për ne shqiptarët.”*

Vepra dramatike ka privilegjin që jeton përmes skenës dhe receptohet drejtpërdrejt nga audienca e cila e ndien dhe e lidh, veçanërisht atë me eksperiencat e veta. Me të vërtetë, komeditë dhe dramat e Kristo Floqit u pëlqyen dhe u pritën shumë mirë nga publiku. Veçanërisht, sukses patën komeditë pasi ato ishin të thjeshta, të këndshme, trajtonin mjedise dhe mendësi shqiptare, karakterizoheshin nga humori dhe e qeshura që buronin nga një sërë situatash komike, ishin të lehta për t’u perceptuar e për t’u vënë në skenë, ndaj ato u shfaqën shumë herë nga pothuajse nga të gjitha teatrot amatore që u krijuan në Shqipëri në atë periudhë (1912-1939).

Po të vihet re, sipas studimit që ka bërë prof. Kudret Velça mbi teatrin e viteve 1912 - 1939, bie në sy mbizotërimi i komedive, e veçanërisht i komedive të Kristo Floqit. Dhe kjo për disa prioritete që ka ky lloj i gjinisë dramatike. Në fakt komedia është cilësuar si një kompensim filozofik, po aq sa dhe psikologjik. Sa herë që ne bëhemi të ndërgjegjshëm se kjo nuk është bota më e mirë e mundshme, na duhet ndihma e komedianëve për të përballur “defektet” e pakapërcyeshme të realitetit. Në të gjitha shoqëritë e civilizuara shpirti komik duhet të qëndrojë lart me buzagaz, të hollë, të vëmendshëm e te tensionuar, sepse asnjë shoqëri nuk është e shëndetshme pa qeshur me veten. Artistët komikë mendojnë se e vërteta mund të marrë çdo lloj drite. Me këtë besim mbështetet kurajoja heroike e komedianit.

Prandaj komeditë e pakta të periudhës 1912 - 1939 kanë pushtuar skenat e teatrove amatorë, pikërisht me mënyrën e lehtë dhe të thjeshtë të ndërtimit, por që nuk harronin të vinte në dukje defekte, gabime e marrëzi të jetës dhe mentalitetit shqiptar duke argëtuar, por njëkohësisht dhe duke bërë të reflektonte publikun shqiptar, i cili nuk kishte si të mos i analizonte në jetën e përditshme tipa si Miti te “*Vllazini e interes*”, Gala te “*Zi e më zi*”, Katina te “*Burri – Burrë!*”, Strumbullari e Sorollopi te “*Akraballëqet*”, si Dudumi te “*Rrogat e nëpunësve*” etj. Këta tipa komikë ishin mbartës të një sërë vesesh e deformimesh morale të dhënë herë përmes humorit pa të keq, herë përmes ironisë e satirës dhe, ndonjëhere përmes sarkazmës e groteskut.

Komeditë e Kristo Floqit, të receptuara kaq gjerësisht nga spektatori i kohës, padyshim kanë qenë një argëtim, por dhe një çlirim energjik të ndryshme, keqardhje, por dhe reflektim mbi personazhe dhe tipa që na bëjnë të qeshim me vese, gabime e marrëzi, por që ne e kemi të vështirë ta pranojmë veten si bartës së tyre. Sidoqoftë, efekti reflektues dhe katharsis ekziston si një mundësi e madhe për të shpjeguar audiencën e gjerë të komedive të Floqit në kohën kur ato u shkruan.

² Gazeta e Korçës, Korçë , 21 korrik, 1920, nr. 10. f.4

Kështu, komeditë e Kristo Floqit i shohim të receptohen përmes skenës, që në vitin 1918, kur grupi teatror i Elbasanit shfaqti *“Dhëndërr me perdhun”* dhe *“E bija e bankierit”*. Të njëjtat komedi u vunë në skenë, më 1925, nga shoqëria “Bashkimi” në Drenovë, nga vajzat dhe gratë e qytetit të Gjirokastrës, me 1930 dhe më 1938 nga grupi teatror i klubit “Ismail Qemali” Vlorë, bashkë me komedinë *“Vllazni e interes”*. Po ashtu, komedia *“Pësimet mësimë”* u vu në skenë për herë të parë më 1920 nga “Shoqëria e Arteve të Bukura” në Korçë.

Në revistën “Agimi”, të datës 10 prill 1920, me rastin e shfaqes së komedisë *“E bija e bankierit”* thuhet: *“Landën e kësaj komedie, si dhe përpilimin e saj nuk është nevoja me i lëvdue, pse prej penës s’auktorit t’onë nuk mundet me dalë ndonji vepër qi të ket nevojë për kritikë.”*³

Ndërsa në gazetën “Zëri i Korçës”, të shkurtit të vitit 1926 shkruhet: *“Komedia ‘Merre ta marrim’, prej K.Floqit u lojt këtë javë dy net me rradhë nga shoqëria ‘Djelmuria korçare’ dhe pati një sukses të kënaqshëm. Në fund të çdo akti duartrokitty të parashtura vazhdonin nga ana e popullit prej të cilave provohej se një kënaqësi dhe simpathi ndjehej në zemrat e tyre”*⁴. Ndërsa në po këtë gazetë, të tetorit të vitit 1927, lexojmë njoftimin mbi vënien në skenë të një tjetër komedie të tij: *“...gjithashtu e lojtën shumë bukur dhe komedinë ‘Dhëndër me përdhuni’. Kjo bëri një përshtypje të mirë nër gjindjen, e cila u shkul së qeshuri.”*⁵

Gjithashtu, komedia *“Lojnat e studentëve”* u vu në skenë në 1924 nga shoqëria teatrore e Gjirokastrës dhe po në të njëjtin vit vihet në skenë nga shoqëria sportive “Vlora”. Komedia *“Merre ta marrin”* u vu për herë të parë në skenë nga e njëjta shoqëri që përmendëm më sipër dhe vihet në skenë, përsëri, më 1936. Sukses ka njohur dhe komedia *“Akraballëket”*, e cila u vu në skenë më 1932, nga shoqëria sportive “Shqiponja” dhe më 1936, nga shoqëria “Muzika dhe Tomorri” në Berat. Ndërsa komedia “E mbesa e krahinarit” u vu në skenë më 1934, nga shoqëria “Puna” në Korçë, më 1939, nga shoqëria “Dragoi” në Pogradec, më 1937 nga grupi teatror i Lushnjës, dhe më 1938 nga grupi teatror “Rinia korçare”. Po ashtu janë vënë në skenë, nga disa trupa teatrore, edhe komeditë *“Do të vras vedin”, “Meço Qafzezi”, “Zi e më zi”* etj.

Lidhur me komeditë e Kristo Floqit dhe vënien e tyre në skenë te gazeta “Zëri i Korçës” shkruhet: *“Më 14 shkurt të dielë mbrëma, shoqëria mirëbërëse ‘Bashkimi’ me anë të djelmoshave të grupit prezantoi në sallën e klubit komedinë ‘Vllazni dhe interes’, ku kishin mbledhur shumicë populli. Komedia u lojt bukur sa të gjithë u kërdisnë së qeshuri.”*⁶

Sukses kanë njohur përmes skenës edhe dramat e tragjeditë e tij. Kështu drama *“Fe e kombësi”*, për mesazhet që përcolli, u vu në skenë disa herë si p.sh. nga grupi teatror i Vlorës më 1928, në Gjirokastrë më 1935 dhe 1936, nga shoqëria “Apollonia” në Fier etj. Po ashtu dhe drama *“Karlo Topia”* njohu disa interpretime: më 192, në Vlorë, me rastin e ardhjes se F.Nolit, më 1928, nga shoqëria “Besa Shqiptare” Shkodër, më 1935, nga grupi teatror “Durrësi” etj.

Në “Gazetën e Korçës”, të gushtit të vitit 1928, thuhet: *“Pardje klubi artistik ‘Devolli’ cfaq i dramën ‘Karlo Topia’ dhe komedinë ‘Reklamë e bllofë’. Çfaqja përfundoi me sukses dhe rrobat ishin të mira. Kjo tregon se djelmoshat tanë kanë etje për art, por shpresojmë se tjetër herë do lozin më mire.”*⁷


Tragjedia *“Pirro Neoptolemi”* u receptua dhe u pëlqye, gjithashtu, për mesazhet që përcillte dhe mënyrën interesante të thurjes së subjektit dramatik. Për këtë arsye ajo u vu në skenë disa here, si më 1926, nga shoqëria “Trupi gjimnastikor” në Pogradec, më 1930, në Korçë etj. Në “Gazetën e Korçës” të marsit të vitit 1935, shkruhet lidhur me shfaqen e kësaj tragjedie: *“Të djelën mbrëma grupi theatral ‘Dragoi’ prezantoi dramën ‘Pirro Neoptolemi’ të K.Floqit, në të cilën asistuan jo vetëm gjithë autoritetet e vendit dhe paria e vendit por dhe një shumicë e madhe populli aq sa disa që arritën vonë u detyruan të qëndrojnë në këmbë. Çfaqja u lojt për mrekulli, prandaj meritojnë përgëzime grupi dhe dretonjësit në fjalë për të tilla shfaqe kaq të dobishme dhe sikurse përherë presin edhe të tjera prej tyre. Marrim vesh se shoqëria e këtushme ka ndërmend që këtë dramë ta cfaqë edhe në disa qytete të tjera si p.sh në Korçë po jemi të sigurt se populli artdashës i Korçës nuk do t’i kursejë përkrahjen e tij morale dhe material.”*⁸

Gjithashtu, në një njoftim të gazetës “Koha” në Korçë mbi daljen e dramës *“Karlo Topia”* thuhet: *“Muarrmë dramën kombëtare ‘Karlo Topia’ me pesë akte prej z.Kristo Floqi. Kjo dramë është më e mbaruar nga të gjitha dramat e tjera gjer më sot, andaj e rekomandojmë në të gjithë. Bliheni pa u mbaruar.”*⁹

Ndërsa në revistën “Leka” ku flitet mbi poemën e tij *“Dëshmorët e Rilindjes”* ose *“Epope e Korçës”* thuhet: *“Të rrallë janë poetët shqiptarë, qi ndër poezi të veta kanë qenë të inspiruem nga ngjarjet historike të vendit e ma të rrallë edhe shkrimtarët që kanë shkruem histori të dokumentueme mbi ndodhitë e ndryshme të rilindjes së atdheut. Për qëllimin e naltë qi ka vepra meriton të përhapet e të lexohet pse vijnë me naltësue e më ushqye zemrat e brezit të ri me shujtjen e fatosavet të vet.”*¹⁰

Duhet përmendur dhe fakti që shumë prej poezive të tij lirike dashurore, të cilat ai i përmbloodhi në vëllimin *“Tingëllimet e Zembrës”* u bënë tekste këngësh, të cilat janë kënduar dhe vazhdojnë të këndohen në Korçë, por dhe më gjerë. Vetë autori në parëthënien e vëllimit shkruan: *“Shumë prej këtyre këngëve u bënë popullore e këndohen sot nëpër qytetet e katundet e Shqipërisë.”*¹¹

Këngë të tilla si: *“Dashuri e parë”*, *“Haj këtu me mua”*, *“Beqari”*, *“Pse moj malësore?”*, *“Burimi i Çardhakut”*, janë bërë pjesë e rëndësishme e këngës lirike qytetare korçare, pjesë e identitetit kulturor dhe shpirtëror të këtij qyteti.



Përsa i përket shkrimeve mbi jetën dhe krijimtarinë e tij letrare duhet pohuar seemri i Kristo Floqit, si autor i njohur shqiptar, përmendet në librin “Shkrimtarë shqiptarë II”, 1941, ku thuhet: *“Kristo Floqi asht nga shkrimtarët ma pjellorë të Shqipnisë; prodhimi i tij letrar në prozë e në poezi asht i mbushulluem e i larëm: ka hartue katër drama, gjashtëmbëdhjetë komedi, gjashtë vëllime në poezi e satira, vepra juridike e letrare dhe artikuj me shumicë nëpër fletore e të përkohshme. Gjuha e veprave asht një toskënishte e rrjedhëshme dhe stili i tyre populluer.”*¹²

Po ashtu, për Kristo Floqin si autor shqiptar ka shkruar dhe Gaetano Petrotta te vepra e tij “Historia e letërsisë shqiptare”, në të cilin ai e cilëson atë si një ndër shkrimtarët që e kanë të siguruar emrin në të ardhmen.¹³

Emri i Kristo Floqit përmendet vetëm një herë në “Historinë e letërsisë shqiptare”, 1983, kur flitet për dramaturgjinë, ndërsa Robert Elsie flet më gjerësisht për jetën dhe veprën e tij tek “Historia e letërsisë shqiptare”, në kapitullin ku trajtohet zhvillimi i dramaturgjisë sonë.

Ai e cilëson Floqin si: *“dramaturgu më popullor shqiptar në gjysmën e parë të shekullit të 20-të.”*¹⁴

Gjatë viteve kur emri i Kristo Floqit nuk përmendej dhe njihej në studimet tona letrare, në Kosovë, studiuesi Hilmi Thaçi botoi tre komedi të Kristo Floqit, shoqëruar me një parathënie mbi jetën dhe veprën komediografike të tij, por të dhënat që sjell janë shumë të pakta. Gjatë viteve të monizmit vepra e Kristo Floqit është përmendur e analizuar vetëm te “Historia e teatrit shqiptar” nga Kudret Velça, ndërsa pas viteve ’90, për Kristo Floqin dhe komeditë e tij është botuar vetëm një shkrim i autorit Jakup Mato “Rreth disa komedive të Kristo Floqit”, ku analizohen tipare specifike të krijimtarisë komediografike të këtij autori. Emrin e Kristo Floqit, po ky autor e përmend shpesh dhe në veprën e tij “Paradokset e satirës dhe humorit”. Edhe profesor Ali Xhiku te vepra e tij “Letërsia shqipe si polifoni”, në kapitullin që flet për dramën shqiptare të traditës trajton dhe dramat dhe tragjedinë e K. Floqit. Gjithashtu, studiuesi Josif Papagjoni përmend emrin e Kristo Floqit si dramaturg i periudhës 1912-39 dhe veprat e tij që u vunë në skenë në këtë periudhë, në enciklopedinë “Teatri dhe Kinematografia shqiptare”.

Përsa u përket disa fakteve të diskutueshme të jetës së K.Floqit, studiuesi Stilian Adhami te artikulli i tij “I anatemuari Kristo. Floqi” shkruan: *“Me gjithë këtë bilanc të pasur, madje voluminos të krijimtarisë së këtij autori, çuditërisht Kristo Floqi dhe vepra e tij, është errësuar dhe lënë në harresë, është përgojuar e përbuzur. Kjo si në kohën e monizmit, ashtu edhe më parë. Me sa dimë ne i vetmi shkak apo ‘faj’ më i madh i tij është se ka shkruar himnin e mbretërisë dhe si i tillë është damkosur me vulën e panegjiristit të monarkut. Por a duhet anatemuar autorë të tillë, që veprimtarinë e tyre atdhetare e krijuese e kanë filluar që në kohë të robërisë osmane?”*¹⁵.

Lidhur me figurën shumë dimensionale të Kristo Floqit ka shkruar dhe gazetari Fiqëri Shahinllari te libri i tij “Lis mbi shkëmb”. Duke analizuar historinë traditat dhe personalitetet e fshatit të tij të lindjes ai shkruan dhe mbi jetën dhe veprën e Kristo Floqit, duke e vlerësuar atë si një nga emrat më të shquar të trevës së tij: *“Kristo Floqi është një prej figurave kryesore elitare të fshatit. Ai është një nga politikanët, shkrimtarët, juristët më në zë të Shqipërisë pas shpalljes së Pavarësisë në vitet ‘20 e ‘30, sidomos në kohën e Zogut.”*¹⁶.

Së fundmi Kristo Floqi është përfshirë dhe në “Fjalorin enciklopedik shqiptar” (2008), botim i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, duke u renditur në radhën e autorëve të letërsisë shqiptare të periudhës ’12-’39.

Në gazetën “Metropol”, të vitit 2004, jepet, gjithashtu, njoftimi mbi vënien në skenë të të komedisë *“Vllazni e interes”* nga trupa e teatrit “Bylis” të Fierit: *“Molieri shqiptar, siç është cilësuar nga kritika shqiptare, Kristo Floqi është ngjitur mbrëmë në skenën e Fierit me ‘Vllazni dhe interes’, nën interpretimin e mrekullueshëm të aktorëve Luftëtar Paja, Fatmir Xheli dhe gjithë trupës së teatrit fierak. Pas një censurimi të gjatë të krijimtarisë së tij, komedia e Kristo Floqit është parë në skenën fierake, duke ngjallur interes të veçantë.”*¹⁷.

Po ashtu, kemi informacion se disa komedi të këtij autori janë vënë në skenë gjatë këtyre viteve dhe në Kosovë.

Shumica e komedive të Kristo Floqit mbartin vlera aktuale, ndaj vënia në skenë e tyre nga teatro dhe aktorë prestigjozë do të sjellë reagim dhe audiencë të gjerë, me karakteret, tipat, situatat komike dhe të qeshurën e këndshme që buron natyrshëm.

Kristo Floqi, sigurisht që tërheq vëmendjen me një krijimtari kaq të pasur, aq të receptuar dhe të mirëpritur nga lexuesi dhe spektatori i kohës. Jo vetëm vepra letrare, por dhe jeta e tij, parë në aspektet më të rëndësishme të saj, me kontributin që ai i dha çështjes kombëtare, do të zgjojë vazhdimisht vëmendjen e studiuesve.

Koha do të verë në dukje, në një të ardhme të afërt, vlerat dhe meritat e këtij personaliteti, i cili i dha shumë prej kulturës, energji dhe aftësive të tij historisë dhe letërsisë shqiptare. Studimet tona në këtë fushë sapo kanë filluar.

³ Revista, *Agimi*, Shkodër, 10 prill, 1920, f. 5.

⁴ Gazeta, *Zëri i Korçës*, 13 shkurt, 1926, nr.61.

⁵ Po aty, Korçë, 1 tetor 1927, nr. 229.

⁶ Po aty, 20 shkurt, 1926, nr. 63.

⁷ Gazeta e Korçës, Korçë, 9 gusht, 1928, nr. 525, f. 4.

⁸ Gazeta e Korçës, Korçë, 1 mars, 1935, nr. 2178.

⁹ Gazeta, *Koha*, Korçë, tetor 1923, nr. 150, f. 2.

¹⁰ Ravista, *Leka, Biblioigrafi*, Shkodër, 1935

¹¹ Kristo Floqi, *Tingëllimet e Zembrës*, Vlorë, 1922, f. 2.

¹² *Shkrimtarët Shqiptarë II*, Tiranë, 1941, f. 252.

¹³ Gaetano Petrotta, *Popolo Lingua e letteratura albanese*, Palermo, 1931, f. 249.

¹⁴ Robert Elsie, *Historia e letërsisë shqiptare*, Tiranë-Pejë, 1997, f. 354.

¹⁵ Stilian Adhami, Gazeta Shqiptare, *“I anatemuari Kristo Floqi”*, Tiranë 20 tetor, 2008, nr. 4377.

¹⁶ Fiqëri Shahinllari, *“Lis mbi shkëmb”*, Tiranë, 2008, f. 83.

¹⁷ Irena Mërtiri, Gazeta Metropol, *“Molieri shqiptar ‘qesh’ pas censurës”*, Tiranë, 4 dhjetor, 2004.



SAUL BELLOW, NOBEL 1976

LEXUES TEPËR SERIOZ TË BOTËS, KINI KUJDES!

Intervistuar ndërsa po priste trenin për të shkuar në Boston, E. M. Forster-i u pyet se si ndihej në prag të vizitës së tij të parë në Harvard. U përgjigj se kishte dëgjuar që kishte disa lexues tepër serioz të librave të tij atje. Priste të pyetej me shumë hollësi nga ata dhe kjo e shqetësonte. Arsyeja është krejtësisht e kuptueshme.

Në këtë epokën që po jetojmë, njerëzit seriozë janë më seriozë se kurrë ndonjëherë dhe një zemër gazmore si të zotit Forster është e vështirë ta gjesh. Për lexuesit tepër serioz, romani është vepër arti dhe arti s'diskutohet që ka një rol për të luajtur në dramën e jetës së qytetëruar e cila ka marrë një drejtim të zymtë dhe të rrezikshëm, prandaj s'mund të hamendësojmë nëse jemi lexues vërtet tepër serioz që asnjë romancier i mirë s'do të na ftonte në një piknik thjesht për të ngrënë sallatë me vezë dhe të lexojmë se si personazhet ndjekin fluturat nëpër livadhet angleze ose përmes pyjeve toskane. Fluturat ngjallin gëzim, në rregull, por tek ato qëndron e fshehta e metamorfozës. Sa për

vezët, misteri i jetës fshihet tek vezët. Këtë e dimë të gjithë. Ja sa shumë domethënie kanë për lexuesit tepër serioz fluturat dhe sallatat me vezë.

Do të ishte e padrejtë të thuash që përgjegjësia për këtë lloj dukurie i takon plotësisht lexuesit. Shpesh vetë shkrimtari ka faj. Pse s'e vret mendjen nëse është pak më lart se mesatarja? Sidoqoftë, leximi tepër serioz ka shkuar shumë larg. Është bërë i rrezikshëm për letërsinë.

-Pse, zotëri, - pyet studenti, - Akili e tërheq zvarrë trupin e Hektorit përreth mureve të Trojës? Kjo tingëllon si një pyetje nxitëse. Shumë interesante.

-Pyetje që ia vlen të diskutohet, - thotë profesori.

-Epo, shihni zotëri, - vijon studenti, -Iliada është plot me rrathë, mburoja, rrota qerresh dhe figura të tjera të rrumbullakëta. Dhe ju e dini se çfarë thotë Platoni për rrathët. Grekët ishin të lindur për gjeometri.

-Të lumtë ajo koka e qethur karre, -thotë profesori,

pasi dëgjon një mendim kaq të bukur. Ka tejndjeshmëri në interpretimin tënd. Ke qasje të thellë dhe serioze. Prapëseprapë, gjithmonë kam besuar se Akili e bëri ngaqë ishte i zemëruar.

Do të duhej një profesor i pazakontë të kuptonte se Akili ishte zemëruar. Për shumë mësues ai do të përfaqësonte shumëçka, por asgjë në veçanti. Profesori ynë, megjithatë, është "i drejtpërdrejtë" në interpretimin e tij dhe studenti i shkëlqyer është i mërzhitur me të. Zemërimi! Çfarë dobie ka zemërimi? Letërsia e madhe është e vështirë, madhështore, e thellë. Homeri është përherë në nivelin e Platonit, dhe nëse Platoni kishte atë mendim për rrathët, Homeri me siguri duhet të ketë përcjellur mendimin e tij, duke shpërfaqur të njëjtin mendim po aq bukur, rreth pas rrethi.

Gjërat nuk janë ato që duken. Dhe sidoqoftë, edhe nëse përfaqësojnë diçka më të madhe dhe të denjë shkrimtarët nuk shqetësohen për këtë. Por një lexues tepër serioz mund të të tregoj se kur personazhi hipën në një autobus në roman, dosja që ai mban në dorë simbolizon vdekjen. Qymyri që dikur përdorej për ngrohje shtëpiake përfaqëson nëntokën. Biskotat e thata përfaqësojnë mikëpritjen. Tre shishe birra janë.... është mëse e qartë. Mendja që s'pushon së interpretuari zor se do të lër t'i shpëtoj ndonjë gjë në këtë lojë dhe çdo lojtar është një fitues.

A jeni marksist? Atëherë Pequod-i i Herman Melvilit tek "Mobi Dik" mund të jetë një fabrikë, menaxheri Ahab, ekip i klasës punëtore. A është pikëpamja juaj fetare? Pequod-i lundroi mëngjesin e Krishtlindjes, një katedrale lundruese drejt jugut. E ndjek Frojdin ose Jungun? Atëherë interpretimet tua mund të jenë të pasura dhe të shumta. Kohët e fundit pata një shpjegim të ri për Mobi Dikun nga një i ri me tru elektronik.

-Interpretimi i fundit dhe që s'e luan topi, - tha ai. -Kjo balenë është nëna e gjithkujt që zhytet në shtratin e saj të ujshëm. Ahabi ka kompleksin e Edipit dhe dëshiron ta çlirojë atë nga ky ferr.

Ky është lexim tepër serioz dhe i thellë. Por është e drejtë të kujtojmë se romancierët dhe poetët më të mirë të shekullit kanë bërë shumë për ta nxitur këtë lloj leximi. Kur Mairy (tek "Uliksi" i Xhejms Xhojsit) humbet lidhësja e veshjeve të brendshme prej pambuku, s'di çfarë të bëjë për t'i mbajtur dhe mendja i shkon nga gramatika tek piktura, nga piktura tek feja. E gjitha tregohet me disa fjalë. Gjenialiteti i Xhojsit mban në ekuilibër të gjithë elementët. Lexuesi tepër serioz sidoqoftë, është i gatshëm të përumbet. Ai përsiat furishëm për çdo rrymë të filozofisë ose fesë duke e bërë gjithçka më të ndërlikuar se sa një aeroplanmbajtëse. A i bëhen pis Blumi rrobat e Stivenit dhe pastron tallashin e drurit? Nuk është tallash dosido por tallash që ka dalë nga kryqi i Stivenit.

Çfarë mund të themi tjetër? Të gjitha veçantitë e vogla të jetës së murgut, me të cilat Robert Brauningu argëtohet tek "Monolog në një manastir spanjoll", vënia e thikës dhe pirunit në pjatë në fund të një vakti dhe gjëra të këtilla, janë bërë kolonat e një sistemi të ri interpretimi. A duhet t'i japim domethënie çdo gjëje që hedh në letër shkrimtari? A është letërsia moderne Bibël? A është kritika letrare Talmud, teologji? Lexues tepër serioz të botës, kini kujdes! Më mirë sigurohuni që serioziteti juaj ka vlerë dhe mos e dhëntë Zoti te jetë një seriozitet pa vlerë.

Një simbol i vërtetë është thelbësor, jo rastësor. S'mund ta shmangni, s'mund ta hiqni. S'e shpërfillni dot shmaninë tek "Otello" ose detin tek "Zezaku i anijes "Narcisi" (Konrad) apo këmbët e shpuara tek "Edipi mbret". Sidoqoftë, mund ta lexoni Uliksin pa dyshuar se tallashi i drurit ka të bëjë me kryqëzimin apo që emri Simon i referohet mëkatit të shitjes së objekteve të shenjta ose që uria e Dublinsave në mesditë ka lidhje me atë të Laestrygonians-ve njerëngrënës. Këto janë çështje thjesht dytësore; përfitime anësore, nëse ju pëlqen t'i quani. Bukuria e librit s'mund t'ju shpëtoj nëse jeni lexues të mirë, dhe është më mirë t'i qases leximit

si lexues naiv, se sa si lexues i ngarkuar me idhujtarinë e kulturës, ndërlikueshmërisë dhe snobizmit. Sigurisht që në kohën tonë është e vështirë të jemi aq naivë sa dëshiron dikush. Informacioni filtrohet. Rrjedh, siç kemi mësuar të themi. Megjithatë edhe njohuritë më të ndërlikuara kanë mangësi ndërsa edhe djajtë më të mençur, të mbushur me të fshehta dhe mistere, del të jenë deri diku të thjeshtë.

Ndoshta lexuesit më seriozë janë ata që ndihen më pak të sigurt. Një dyshim edhe më shqetësues është se ata parapëlqejnë të kuptojnë para se të ndjejnë. Çfarë, përsëri me ndjenjat do merremi? Po, më vjen keq që duhet ta përmend këtë temë të lodhshme, por është e pashmangshme. Arsyeja që studenti arratiset tek rrathët është se zemërimi i Akilit dhe vdekja e Hektorit janë shumë për të. Ai po bën atë që bën shumica e njerëzve të civilizuar kur përballen me pasionin dhe vdekjen. Në një farë mënyre përpiqen t'i shmangin ato.

Praktika e shmangies është kaq e përhapur sa ndoshta s'është e drejtë të veçosh ndonjë grup për ta fajësuar. Por nëse asgjë nuk thuhet ose bëhet, edhe ne mund të bëhemi gati për ta braktisur letërsinë. Sot po botohen romane gati fund e krye me abstraksione, kuptime, dhe ndërsa nevoja jonë për kuptime është sigurisht e madhe, nevoja jonë për gjëra konkrete, për veçoritë, është edhe më e madhe. Kemi nevojë të shohim si veprojnë qeniet njerëzore pasi të kenë përvetësuar kuptimet. Kuptimet vetë janë me shumicë. Në letërsi njerëzimi bëhet abstrakt kur fillojmë të mos e pëlqejmë. Dhe...vjen ndërhyrja nga lexuesi tepër serioz: Po, po, ne i dimë të gjitha këto. Por vetëm hidhu një sy romaneve të konkretes dhe të veçantës, njerëzit që hapin dyert dhe ndezin cigaren. A s'janë të mërzhitshëm? Për më tepër, a doni që ne të miratojmë një program për të zvogëluar frikën e njeriut dhe të pretendojmë se na pëlqejnë krijesat prej mishi dhe gjaku? Sigurisht që jo. Asnjë program. Një shteg i bukur ku kemi arritur!

Duheta t'ia lëmë frymëzimit të jap konkretën dhe të veçantën dhe për të rigjetur vlerën e mishit dhe të kockave. Ndërkohë, le ta lëmë Platonin me rrathët e tij dhe t'i lejojmë biskotat e thata të jenë biskota të thata, tallashin e drurit, thjesht tallash druri. Ato mbartin mjaft mister edhe kështu siç janë.

SHKRIMTARI DHE LEXUESIT E TIJ

Johan Ekermani ka shkruar një thënie të Gëtes se shkrimtari s'duhet ta marr penën të shkruaj, nëse nuk synon që fjalët e tij të lexohen nga të paktën një milion lexues. Askush, përpos ndonjë autori të çuditshëm s'do të binte dakord me këtë pohim. Natyrisht që një romancier dëshiron të lexohet. Vetëm, nëse nuk është shkrimtar popullor, mund të mos jetë i kënaqur me idenë se duhet t'i gjejë. Nuk do të dojë të kushtëzohet prej tyre, përkundrazi, t'u tregoj se çfarë ata duhet të jenë. Dhe do që lexuesit të hamendësojnë atë që hamendëson personazhi i tij i trilluar. Kur një personazh plagoset, lexuesi duhet të ndiej dhimbje. Kur personazhi bën një premtim, lexuesi duhet të ndiejë parimet themelore të këtij zotimi. Kur Lordi Xhim hidhet në ujë, lexuesi duhet të kuptojë se nderi është humbur. Duke mos pasur një ndjenjë nderi, ai s'mund ta pranojë çastin dramatik. Qëllimi i shkrimtarit, kësisoj, është t'i jap lexuesit një ndjesi të peshës së çdo veprimi. Shkrimtari s'mund të jetë i sigurt se një milion lexuesit e tij do ta shohin çfarë lexojnë njësoj si ai. Prandaj shkrimtari përpiket ta përcaktojë një lexues të caktuar. Duke hamendësuar se çfarë është ajo të cilën të gjithë njerëzit duhet të jenë në gjendje të kuptojnë dhe të bien dakord për të, ai krijon një lloj njerëzimi, një version të tij të përbërë nga shpresat dhe realitetet me përmasa që ndryshojnë sipas shkallës së tij të optimizmit.

Nietzsche deklaroi në "Njerëzor, tepër njerëzor" se artistët e teprojnë vazhdimisht me vlerën e personalitetit. Sigurisht që teprimi është

domosdoshmëri dramatike, dhe thjeshtëzimi gjithashtu. Nëse një hero është i parëndësishëm edhe fati i tij s'ka rëndësi. Nëse një jetë e vetme ka sadopak rëndësi, vdekjet nuk janë veçanërisht frikësuese. Në mbrojtje të elementit dramatik, rrjedhimisht, shkrimtari ka këmbëngulur shpesh që t'i jepte një vlerë të caktuar realitetit. Në këtë drejtim shkrimtarët janë konservatorë, duan që marrëveshjet e vjetra dhe mirëkuptimi të zgjasin. Personazhi yt keqbërës s'mund ta shantazhojë heroin tënd nëse hero i yt nuk shquhet të jetë nga ata që që mbrohet. Heroina jote s'mund të presë që dikush të vdesë në mbrojtje të delirësisë së saj nëse askush s'e vlerëson delirësinë.

Ndonjëherë një romancier është në gjendje të bëjë të qëndrueshëm një sistem të tërë të krijuar plotësisht nga imagjinata e tij. Për shembull, Balzaku qëndron mu në mes të shoqërisë, një inteligjencë laike e aftë të interpretojë gjithçka. Mençuria e tij është e pashtershme. Ai kurrë nuk është i pasigurt për teorinë, fiziologjike, psikologjike, politike, historike, estetike dhe shpjegon çdo dukuri me besim. Për të shkruar letërsi Balzaku zotëron, ose mëton se zotëron të gjithë përvojën. Edhe tek Tomas Mani shihet kjo metodë enciklopedike në fazën e shterimit. Për të vërtetuar faktet, për t'ju bërë t'i shihni siç i sheh ai, shkrimtari bëhet, ose përpiket të bëhet, ekspert në disa fusha: biologji dhe psikologji, filozofi dhe muzikë, arkeologji dhe histori, dhe të gjitha kështu që ne të ndihemi ashtu si ndihet ai në çdo përjetim të dhënë.

Ne s'mund të vazhdojmë të ndërtojmë në çdo roman sisteme të tilla totale në mënyrë që të gjithë të dinë se çfarë, për shembull, një grua përjeton kur i shoqi e braktis, çfarë ndjen njeriu në shtratin e vdekjes. Duhet të guxojmë të besojmë në unitetin psikik të njerëzimit. Por sigurisht njerëzit, lexuesit s'do të hamendësojnë gjithmonë atë që hamendësojmë ne, pasi Uollt Uitmani na ngjall besim.

Shumica e gjërave që të gjithë njerëzit duhet të jenë në gjendje të kuptojnë janë mjaft të thjeshta, dhe është befasuese se sa mëson për shformimin e perceptimit gjatë shkrimit të një libri. Mëson në radhë të parë se sa e vështirë është t'i bësh njerëzit t'i kushtojnë vëmendje të tjerëve si qenie shumë përmasore dhe të ndërlikuara. Një arsye e mundshme për këtë është se jemi kaq shumë, dhe është e vështirë, në mos e pamundur t'i kushtosh secilit vëmendjen e nevojshme. Nëse kërkon më shumë vëmendje, të shohin si mendjemadh dhe që të ka hyrë vetja në qejf.

Prandaj shumica e njerëzve në vetë-paraqitjen e tyre para botës përdorin disa tipare të thjeshta dhe krijojnë një potret të lehtë për t'u përshkruar dhe kuptuar. Por nën këtë paraqitje është qenia e tyre reale, e ndërlikuar,

permasa private. Kodi që e mbron këtë intimitet është i fuqishëm dhe i hollësishëm. Disa emocione janë në rrjedhën e humbjes së formës së tyre të jashtme, dhe për shkak se nuk shpërfaqen, atrofizohen. Bashkë me to atrofizohet ndjenja përkatëse e realitetit. Përpjekja e fshehur, veprimtaria e unit e mbyllur brenda teje, krijime të mëdha dhe nganjëherë të mrekullueshme të fantazisë vetjake, e bëjnë kuptimin e ekzistencës së të tjerëve jo atë që ishte dikur. S'po them që kjo s'është në vetvete tërheqëse por është padyshim ndryshe. Nëse e prisnin Shajlokun ai ndoshta në ditët e sotme s'do të kishte gjak, siç bëjnë të tjerët.

Ajo që po përpiqem të them është se njerëzit s'duket se reagojnë njëllë si dikur ndaj fytyrave të ndryshme të realitetit. Gjëra të panumërta ndërhyjnë për të megjulluar apo tjetërsuar reagimet. Fyerjet nuk jepen ose kundërshtohen siç ndodhte me Brutin apo Kasin e Shekspirit ose nga personazhet e Prosper Merimes, padrejtësitë nuk pranohen shpejt, dhimbjeve u duhet kohë që të ndjehen, po ashtu edhe kënaqësitë. Nuk kemi të njëjtën reagim të menjëhershëm. Analiza dhe përlllogaritja hyjnë në mes ndërkohë. Shpesh jemi të vetëdijshëm për personalitetin modern të një sistemi që merret me shumicën e situatave. Ky sistem e di se çfarë është e përshtatshme në çdo rast të caktuar.

Për shembull: një mik sëmuret, ndjenjat tona mund preken ose jo nga kjo ngjarje, por sistemi e di se çfarë duhet të bëhet dhe sillemi shoqërisht sikur jemi të prekur nga gjendja e të sëmurit. E shohim funksionimin e këtij sistemi si normalitet. Nëse sugjerohet që gjithçka tjetër është normale, sistemi tregon shqetësim. Sistemi i do abstraksionet, natyrisht, dhe s'është miqësor ndaj imagjinatës, parapëlqen gatishmërinë për nxitje, brenda mendjeve të një milion lexuesve të Gëtes, ajo i reziston formave të reja të realitetit. Kjo është vetëm për të thënë se kërkohet aq shumë nga ne, sa ndjenjat tona do të ishin aq të tepërta nëse do të duhej të përfshiheshin menjëherë në të gjitha ndërvperimet e shpejta dhe të ndërlikuara, me të cilat përballemi edhe në një mëngjes të zakonshëm. Sistemi është i domosdoshëm por ka uzurpuar një vend shumë të madh.

Përtej këtij sistemi (ose më mirë, këtyre sistemeve, sepse në audiencën tuaj prej një milion lexuesish do të ketë një numër të madh trillimesh të tilla) shkrimtari duhet të gjejë intuita të qëndrueshme se cilat janë gjërat reale dhe cilat gjëra janë të rëndësishme. Puna e tij ka të bëjë me këto intuita të qëndrueshme që kanë fuqinë të njohin raste vuajtjesh ose raste lumturie, pavarësisht nga çdo shtrembërim dhe paqartësi të krijuar nga sisteme jashtë tij.

Përktheu: Granit Zela



Reflektim i përkthyeses për romanin “Uria” të shkrimtarit J. Ouariachit

NJË UDHËTIM PËR BOTËN, JETËN DHE VDEKJEN



Është darkë vonë. Edhe pak dhe mbaroj me përkthimin e romanit *Uria* të shkrimtarit J. Ouariachit, i nominuar për Fintro Literature Prize dhe më 2017 fitues i Çmimit European për Letërsinë.

Gjithë bota ku sillen personazhet e librit të tij është aq e njohur dhe e dashur për mua.

Amsterdami fle.

Ashtu si Aurelia, personazh kryesor në roman, edhe unë jam endur për shume vite tashmë rrugëve të qytetit në këmbë e me biçiklete nga shtëpia në punë, nga puna në kopsht e në shkollën e fëmijëve, në pazar, në kinemanë Kriterion, në universitet, në disko, në klub, në park. Ashtu si edhe personazhi tjetër, Aleksandri, edhe unë punoj me një organizatë që ndihmon vendet në zhvillim.

Dhe deri këtu jeta e tyre nuk ka asgjë të jashtëzakonshme. Lind, rritesh, shkollohesh, martohesh, lind fëmijë, u gëzohesh, shpreson të plakesh me dinjitet dhe i shëndetshëm në një vend ku mbizotëron paqja dhe harmonia, në një vend plot mirëqenie, që frymon liri dhe tolerancë.

Historia e dhimbshme e botës në zhvillim, luftërat, konfliktet, diktaturat, mungesat, dhuna dhe uria, nuk janë dhe nuk ka përse të jenë edhe historia jote. Atje individit është një numër, këtu gjithçka sillet rreth individit, zgjedhjes së tij të lirë.

Ndërkohë që shkruaj këta rreshta, anija e policisë së portit kalon buzë dritareve të apartamentit tim, që sheh mbi lumit IJ. Jetoj në katin e dytë dhe sytë tanë takohen. Natën e mirë, sikur më përshëndesin ata. Shko fli, boll ndenje zgjuar, nata është jona. Ji e qetë. Ji e sigurt. Gjërat janë nen kontroll.

Dhe kështu është, kështu duhet të jetë.

Por deri në çastin “kur të rrëshqet këmba”, siç ngjet me Aleksandrin. Deri në çastin kur, pa dashje, zgjon demonët e urrejtjes, të zemërimit popullor, zgjon zilinë dhe babëzinë. Atëherë turma, opinionit, shoqëria, qytetaria, komuniteti (pa ty), media, ah media, të gjithë të vihen kundër. Asnjëri nuk të dëgjon, as të beson. Aq më tepër kur luhet me më të pafajshmit - fëmijët. Kafshatë që s’kapërdihet për shoqërinë, të luash me ndjenjat e sigurinë e tyre. Je i mbaruar. Je i dënuar. Je vetëm. Edhe vajza që e doje me shpirt, nuk është më pranë teje. Je aq vetëm, sa mund të rrish me ditë të tëra pa e hapur gojën, jo vetëm në burg por edhe jashtë tij. Mund të qelbesh i vdekur në shtëpinë tënde dhe askush nuk do ta ndiejë mungesën tënde.

Sepse ty të është vënë viza. As nuk bëhet fjalë për mëshirë ndaj teje. Mëshira është për botën në zhvillim. Për ata zezakët e vegjël me sytë ku gëlojnë mizat e barkun e kanë bosh. Ata zezakët që ti i more dhe na i solle këtu që t’i bëje njerëz. Çfarë hipokrizie!

Kjo është dilema e Aleksandër Laszlos. Të hapë gojën, të flasë, të rrëfejë, të shkaktojë më shumë indinjatë, të mbrojë mendimin e lirë? Apo

të rrijë gojëkyçur e të mbajë “kryqin” mbi shpinë?

Si humanist, si erudit, si kokëfortë, si njeri që do të ketë dinjitet, ai zgjedh fjalën, ai zgjedh debatin dhe në këtë mënyrë edhe konfrontimin. Duke dashur të lajë hesapet me ata që e gjykuan, ai i vë një pasqyrë shoqërisë, qytetarisë, turmës.

A nuk po luan me zjarrin? A nuk po e ekzagjeron? Çfarë ndodh?


Për këtë duhet të lexoni librin dhe të ndiqni në labirintin e jetës këta dy personazhe që dashurohen në kohë urie. Urie? Po, po urie, në Etiopi. Atje filloi.

Anija e portit kaloi përsëri përpara dritareve të

shtëpisë sime. Ka filluar të zbardhë. Sot janë bërë katër javë që, si miliona njerëz nëpër botë, jam ngujuar në shtëpi për shkak të pandemisë së COVID 19.

Ndoshta botët tona me dhe pa uri, me dhe pa Covid 19, me dhe pa demokraci e liri, nuk janë aq larg njëra-tjetrës. Historitë tona aq sa janë të përveçme, janë pjesë të së tërës. Histori dashurie për jetën të ndërthura aq bukur në këtë roman, i cili mendoj e ka merituar të vijë edhe te lexuesi në shqip.

Lexim të mbarë!
Albana Shala





Në vitin 1922 gruaja e Buninit, Vera Nikollajevna Muromceva, ka shkruar në ditar se Romain Rolland kishte paraqitur kandidaturën e Buninit për të marrë çmimin Nobel. Që nga ajo kohë Bunini jetoi me shpresa se dikur do ta merrte këtë çmim. Në vitin 1933 ai u bë i pari shkrimtar rus që u nderua me çmimin Nobel për letërsinë. Në Stokholm Bunini iu dorëzua një dosje me diplomën e Nobelit, një kuti me medaljen e artë dhe një çek prej 715.000 frangash franceze.

IVAN BUNIN (ÇMIMI NOBEL 1933)

DITËT E MIA TË NOBELIT

Është 9 nëntor 1933. E vjetra, e mira Provancë, i vjetri, i miri Gras, ku kalova plot dhjetë vjet të jetës, pothuaj pa ndërprerje; një ditë e qetë, e ngrohtë, e hirtë e vjeshtës së vonë...

Në ditë të tilla kurrë nuk shtrohem për të punuar. Megjithatë, si përherë, që në mëngjes jam pranë tryezës së shkrimit. Kthehem përsëri aty, pasi ha mëngjesin. Por, kur shikoj në dritare dhe vërej se po afrohet shiu, i them vetes: “Jo, nuk më punohet. Ka

një shfaqje filmi pasdite në kinema. Do të shkoj në kinema.”

Duke zbritur kodrën ku ndodhet Belvedere, shoh Kanën që shtrihet së largu, detin e mezidukshëm në këto ditë, kreshtat e mjegullta të Esterelit, e kap veten duke menduar: “Mbase, pikërisht tani, diku, në një skaj tjetër të Europës, po vendoset fati im...”

Por në kinema e harrova krejt Stokholmin.

Kur, mbas intervalit, në ekran u shfaq një pjesë

e gëzueshme, pa kuptim, e titulluar “Baby”, po e ndiqja me shumë interes: ishte Kisa, vajza bukuroshe e Kuprinit, që interpretonte aty. Por ja, befas, në errësirë, dëgjoj pranë meje një zhurmë të lehtë, pastaj drita e një elektriku dore dhe dikush që më prek në sup dhe dëgjoj një pëshpërimë në vesh, një përzierje e druajtjes dhe emocionit.

- Ju telefonojnë nga Stokholmi...

Dhe, befas, krejt jeta ime e mëparshme ndryshoi.

Shkova drejt shtëpisë pothuaj nxitimthi dhe nuk ndieja asgjë, përveç keqardhjes se nuk munda ta shihja deri në fund se si do të luante Kisa dhe njëfarë mosbesimi për lajmin që më komunikuan. Por jo, nuk mund ta besoja; së largu shihej shtëpia ime, e cila në këtë kohë përherë ishte e qetë dhe në gjysmerrësirë, e humbur mes ullishtave që mbulonin shpatet e kodrës mbi Grasse, tani ishte ndriçuar fund e krye. Një si trishtim po më shtrëngonte zemrën... Një lloj përmbysjeje në jetën time...

Gjithë mbrëmjen “Belvedere” kumbonte nga zilet e telefonit, prej të cilit thërrisnin njerëz në gjuhë të ndryshme, pothuaj nga të gjitha kryeqytetet europiane, dëgjohej zilja e derës prej postierëve që veç sillnin telegrame përshëndetëse pothuaj nga të gjitha vendet e botës – ngado, përveç Ruisë! – dhe përballja me dyndjet e para të vizitorëve të çdo lloji, fotografët, gazetarët... Vizitorët, numri i të cilëve veçse rritet, sa që fytyrat e tyre shkrihen para meje, nga të gjitha anët më shtrëngojnë duart, të emocionuar dhe gjithë duke thënë të njëjtën gjë. Fotografët më verbojnë me flashet, që të shpërndajnë pastaj në të gjithë botën portretin e zbehtë të një të lajthituri. Gazetarët, si në një garë, më bombardojnë me pyetje:

- Kur jeni larguar nga Rusia?

- Jam emigrant që nga fillimi i vitit 1920.

- Mos po mendoni të ktheheni atje tani?

- Zoti im, po përse duhet të kthehem tani atje?

- A është e vërtetë që jeni i pari shkrimtar rus që e ka marrë ndonjëherë çmimin *Nobel*?

- E vërtetë.

- A është e vërtetë që dikur ia ofruan Lev Tolstoid dhe ai refuzoi ta marrë?

- E pavërtetë. Çmimi nuk i ofrohet askujt. Çmimet vendosen në fshehtësi të plotë.

- A keni pasur lidhje apo njohje në Akademinë Suedeze?

- Kurrë dhe asnjë.

- Për cilën vepër tuajën ju akordua çmimi?

- Mendoj, për tërësinë e veprës sime.

- E prisnit që të fitonit?

- E kam ditur prej kohësh që isha në listën e kandidatëve. Gjithashtu, kam lexuar shumë vlerësime miklonjëse për veprën time nga kritikë të njohur skandinave, si Böök, Osterling, Agrell; meqë kisha dëgjuar për lidhjet e tyre me Akademinë Suedeze, kam hamendësuar që ata do të ishin në favorin tim. Por, natyrisht, nuk isha i sigurt për asgjë.

- Kur jepet zakonisht çmimi *Nobel*?

- Çdo vit në të njëjtën datë: 10 dhjetor.

- Pra, ju do të jeni në Stokholm në këtë datë?

- Me shumë gjasa, më herët: mezi po pres të shijoj kënaqësinë e një udhëtimi të largët sa më shpejt. Për shkak se një emigrant ka shumë vështirësi për të marrë një vizë, prej trembëdhjetë vjetësh nuk kam shkuar askund jashtë shtetit, përveçse një herë në Angli. Për mua, që kam bredhur botën, ka qenë një nga privimet më të rënda.

- A keni qenë në ndonjë vend skandinav?

- Jo, kurrë. Kam bërë, po e përsëris, shumë udhëtime, edhe të largëta, por gjithmonë drejt lindjes dhe drejt jugut, kurse Veriun ia kisha lënë së ardhmes, e cila nuk erdhi kurrë...

Kaq papritur më përfshiu ky përrua i rrëmbyer, i cili u shndërrua shpejt në një lloj jetese të çmendur: asnjë minutë të lirë dhe të qetë nga mëngjesi në mbrëmje. Përveç gjendjes së natyrshme që rrethon çdo laureat nobelist, kisha diçka të veçantë, për

shkak të situatës sime të jashtëzakonshme, sepse i përkisja asaj Rusie të tjetër e cila ishte shpërndarë nëpër botë, më kishte ndodhur diçka që nuk i kishte ngjarë asnjë laureati tjetër: vendimi i Stokholmit ishte bërë një ngjarje vërtet kombëtare për gjithë atë Rusi kaq të poshtëruar dhe të fyer në të gjitha ndjenjat...

II

Natën e tre dhe katër dhjetorit ndodhesha tashmë larg Parisit. Nord-Express, një kupe e veçantë e klasit të parë – sa vjet që nuk kisha përjetuar ndjenja të tilla! Kishte kaluar mesnata dhe ndodheshim në Gjermani. Qëndroj në korridorin e vagonit, i cili është i fundit në varg. Dhe, duke rrëshqitur poshtë vagonëve, mbetet prapa nën dritën e zbehtë të hënës diçka që më kujton Rusinë: rrafshina të gjera, të përzishme, të larme, pemë të mbuluara me borë...

Në mëngjes jemi në Hanover. Hap sytë, ngre perden – dritarja me akull, ngrica. Akull edhe në shina. Njerëzit që kalojnë nëpër platformë, me kokore prej gëzofi, me peliçe – sa kohë që nuk e kisha parë diçka të tillë, siç duket, e kisha ruajtur gjallë në zemër!

Në mbrëmje treni vendoset në avulloren “Gustav V” dhe ngadalë u afrohem brigjeve të Suedisë. Përsëri intervista, përsëri drita verbuese e flasheve... Në Suedi vagoni im rrethohet krejtësisht nga turma e fotografëve dhe e gazetarëve... Dhe vetëm natën vonë mbeta fillikat përsëri. Përtej dritareve errësirë dhe bardhësi – pyjet e dendura të zeza në dëborën e bardhë të thellë. Dhe të gjitha këto, së bashku me kupenë e nxehtë valë, krejt si netët në rrugën *Nikollajevskaja*...

Dhënia e çmimeve *Nobel* fillon çdo vit në 10 dhjetor, fiks në orën pesë të mbrëmjes.

Atë mëngjes trokitja në derën e dhomës sime të gjumit u dëgjua herët. Në mbrëmje ishin urdhëruar të më zgjonin në orën tetë e gjysmë. Ngrihem shpejt dhe menjëherë kujtohem se ç’ditë është sot: është dita më e rëndësishme. Ka shkuar tetë, mëngjesi verior mezi po zbardh, digjen fenerët në pendën e kanalit që shihet prej dritareve të mia dhe ajo pjesë e Stokholmit mbi kanal, përballë meje, me kullat, kishat dhe pallatet e saj, e cila po ashtu ishte krejt e ngjashme me Peterburgun, edhe me një bukuri përrallore, siç ndodh vetëm kur perëndon apo agon. Por unë duhet ta filloj ditën më përpara: dhjetë dhjetori është data e vdekjes së Alfred Nobelit, prandaj që në mëngjes duhet që të vë një kapelë cilindër dhe të shkoj jashtë qytetit, te varrezat, ku duhet të vendos kurora edhe në varrin e tij edhe në varrin e nipit të tij Emmanuel Nobel, që kishte vdekur para do kohësh. Edhe dje kisha rënë për të fjetur në orën tre të natës dhe tani, duke u veshur, e ndiej veten të këputur. Por kafeja e nxehtë dhe e fortë, dita e kthjellët, akull e ftohtë, mendimi për ceremoninë e jashtëzakonshme, e cila më priste sonte në mbrëmje, më sjell në vete.

Ftesa zyrtare për ceremoninë u dërgohet laureatëve disa ditë përpara. Ajo është hartuar (në gjuhën frënge) në përputhje të plotë me saktësinë që dallon gjithë ritualet suedeze:

“Zotërinjtë laureatë ftohen të vijnë në Sallën e Koncerteve për të marrë çmimin *Nobel* më 10 dhjetor 1933, jo më vonë se ora 4 e 50 minuta e ditës. Madhëria e Tij, i shoqëruar me shtëpinë mbretërore dhe gjithë oborrin, ju pret në Sallë, që të jetë i pranishëm në ceremoni dhe personalisht t’iu dorëzojë secilit prej jush çmimin e duhur, fiks në orën 5, pas së cilës dyert e Sallës do të jenë të mbyllura dhe do të fillojë vetë ceremonia.”

Të vonohesh një minutë apo të vish sikur dy minuta para afatit të caktuar në çfarëdo ftese suedeze është krejtësisht e palejueshme. Prandaj filloj e vishem pothuaj që nga ora tre e ditës, nga frika se ç’mund të ndodhë; po ja sikur befas të zhduket

komça e këmishës së frakut, siç u teket ta bëjnë gjitha komçat në botë në të tilla raste?

Në katër e gjysmë nisemi.

Qyteti këtë mbrëmje është ndriçuar veçanërisht për nder të laureatëve dhe për kremtimin së afërmi të krishtlindjeve dhe Vitit të Ri. Drejt Sallës gjigante të Koncerteve, ku do të zhvillohet ceremonia, rrjedh një rrymë aq e dendur dhe e pafund veturash, sa shoferi ynë, një djalosh trupmadh me një kokore prej lëkure me push, mezi përparon. Nga kjo gjendje na nxjerr vetëm policia, duke ndaluar makinat e tjera, kur sheh kortezhin e laureatëve, të cilët në këto raste shkojnë njëri pas tjetrit.

Ne laureatët, me gjithë turmën e njerëzve, hyjmë në Sallën e Koncerteve, por në holl na ndajnë menjëherë nga turma dhe na çojnë në kalime të veçanta, kështu që, çfarë po ndodh në sallën gala para se ne të shfaqemi në podium, e marr vesh nga të tjerët.

Salla të habit me lartësinë dhe hapësirën e saj. E zbukuruar krejt me lule dhe e mbushur përplot me njerëz: qindra dama me veshje mbrëmjeje, diamante dhe brilante, qindra burra me frak, yje, medalje, fjongo larmingjyrëshe dhe shenja të tjera ceremoniale. Në orën pesë pa dhjetë minuta i gjithë kabineti i ministrave suedeze, trupi diplomatik, akademia suedeze, anëtarët e Komitetit Nobel dhe e gjithë turma e të ftuarve ishin në vendet e tyre

dhe mbanin një qetësi të thellë. Në orën pesë fiks fanfarat lajmëruan ardhjen e mbretit. Pastaj fanfarat ua lanë radhën tingujve të mrekullueshëm të himnit kombëtar, që s’kuptohej se nga derdheshin prej së larti, dhe mbreti hyn i shoqëruar nga Princi i Kurorës dhe të gjithë anëtarët e familjes mbretërore. Pas tyre vjen suita dhe oborri. Ne, katër laureatë, ndodhemi në këtë kohë ende në atë sallë të vogël, që është ngjitur me hyrjen e pasme në podium.

Ja edhe momenti i daljes sonë. Fanfarat u dëgjuan përsëri dhe ne ndjekim ata akademikë suedeze, të cilët do të na paraqesin dhe do të referojnë për ne. Unë jam caktuar të flas i pari në banket pas marrjes së çmimit. Sipas ritualit, dal i fundit në podium. Mua më paraqet Per Hallstromi, sekretari i përhershëm i Akademisë. Sapo hyra, u befasova nga eleganca, nga shumënjerëzia e sallës dhe sidomos, kur të gjithë laureatët hynë duke përshëndetur me kokë, ngrihet jo vetëm e gjithë salla, por edhe vetë mbreti me të gjithë oborrin dhe familjen.

Podiumi gjithashtu ishte gjigant. Ishte zbukuruar me lule të vogla të freskëta ngjyrërozë. Në anën e djathtë ishin poltronët e akademikëve. Katër poltronë të radhës së parë majtas ishin rezervuar për laureatët. Mbi gjithçka, palëvizshmërisht, vareshin nga muret pëlhura të flamurit kombëtar suedeze: zakonisht podiumin e zbukurojnë flamujt e atyre vendeve që u përkasin laureatët. Por çfarë



flamuri kam unë vetë, emigranti? Pamundësia për të varur për mua flamurin e Rusisë Sovjetike i detyroi organizatorët e ceremonisë të kufizohen, për shkakun tim, vetëm me një flamur, atë suedez. Sa fisnikë!

Festën e hapi presidenti i Fondacionit Nobel. Ai përshëndeti mbretin dhe laureatët dhe ia dha fjalën konferencierit, i cili ia kushtoi gjithë fjalën e tij kujtimit të Alfred Nobelit, sepse ishte njëqindvjetori i lindjes. Pastaj vijuan referatet kushtuar secilit prej laureatëve dhe më pas çdo laureat ftohej nga konferencieri të zbriste nga podiumi dhe të merrte nga duart e mbretit dosjen me diplomën e Nobelit dhe kutinë me një medalje të madhe prej ari, në njërën anë të së cilës ishte gdhendur portreti i Alfred Nobelit, kurse në anën tjetër emri i laureatit. Në interval u luajt muzikë nga Beethoven-i dhe Grieg-u.

Grieg-u është një nga kompozitorët e mi të dashur, ndaj me një kënaqësi të veçantë i dëgjoja tingujt e tij para se të referonte për mua Per Hallstromi. Minuta e fundit më emocionoi shumë. Fjala e Hallstromit jo vetëm ishte e mrekullueshme, por ishte vërtet e përzemërt. Si përfundoi, me një ceremonialitet sharmant, m'u drejtua frëngjisht:

"Ivan Alexeyevich Bounine, voulez-vous descendre dans la salle pour recevoir des mains de Sa Majesté le prix Nobel de littérature 1933 que l'Académie Suédoise vous a décerné?" (*Ivan Aleksejevic Bunin, dëshironi të zbrisni në sallë për të marrë nga duart e Madhërisë së Tij çmimin Nobel për letërsi 1933 që Akademia Suedeze ju ka akorduar?*)

Në heshtjen e thellë që ra, eca ngadalë përgjatë podiumit dhe po ngadalë zbrita shkallët e tij drejt mbretit, i cili u ngrit dhe po më priste. E gjithë salla u ngrit në këtë kohë, duke mbajtur frymën, që të dëgjonin se çfarë do të më thoshte ai mua dhe se si do t'i përgjigjesha unë. Ai më përshëndeti dhe nëpërmjet meje, gjithë letërsinë ruse, me një shtrëngim të fortë duarsh dhe dashamirësi të veçantë. Duke u përulur para tij, iu përgjigja në frëngjisht:

"Sire, je prie Votre Majesté de daigner accepter l'hommage de ma profonde et respectueuse gratitude." (*Zotëri, i lutem Shkëlqesisë Suaj të denjojë të pranojë konsideratën e mirënjohjes sime të thellë dhe të respektuar.*)

Fjalët e mia u mbytnë nga duartrokitjet.

Mbreti nderon laureatët me një drekë në pallatin e tij të nesërmen pas festës së dhënies së çmimeve. Po në mbrëmjen e datës dhjetë dhjetor, pothuaj menjëherë pas përfundimit të festës, na çojnë në një banket që shtron Komiteti Nobel. Kur arritëm, gjetëm përsëri anëtarët e Akademisë, gjithë familjen mbretërore dhe oborrin, trupin diplomatik, botën artistike të Stokholmit dhe të ftuar të tjerë. Çifti i parë që shkoi tek tryeza, ishte Princi i Kurorës dhe gruaja ime, të cilët u ulën në qendër. Vendi im ishte pranë princeshës Ingrid – tani ajo është mbretëreshë e Danimarkës – përballë princit Eugene, vëllai i mbretit (rastësisht, piktor i mirënjohur suedez).

Princi i Kurorës hap fjalimet. Foli shkëlqyeshëm, duke ia kushtuar fjalimin e tij kujtimit të Alfred Nobelit. Pastaj u vjen radha laureatëve që të flasin. Princi flet nga vendi. Ne në një tribunë të veçantë, në thellësi të sallës së banketit, po ashtu jashtëzakonisht e madhe, e ndërtuar në stilin e vjetër suedez.

Radioja emetonte fjalët tona nga ky podium në krejt Europën.

Ja teksti i përpiktë i fjalës sime që e mbajta frëngjisht:

"Lartësia Juaj, të dashur zonja, të dashur zotërinj.

Më nëntë nëntor, shumë larg nga këtu, në një qytet të vjetër në Provancë, në një shtëpi të thjeshtë fshati, nga telefoni mësuam për vendimin e Akademisë Suedeze. Nuk do të isha i singertë, nëse nuk do t'ju tregoja, siç thuhet në këto raste, se ky ishte momenti më emocionues i jetës sime. Sikundër ka thënë me të drejtë një filozof i shquar, ndjenjat e ngjallura prej



Dy foto nga Ceremonia e marrjes së Çmimit Nobel



gëzimit, madje edhe ato më kulmore, pothuaj as që mund të krahasohen me ndjenjat që ngjallen prej pikëllimit. Pa dashur të errësoj këtë festë, për të cilën do të ruaj përgjithmonë një kujtim të pashlyeshëm, megjithatë, do t'ia lejoj vetes të them se hidhërimet që kam provuar pesëmbëdhjetë vjetët e fundit i kanë kaluar së tepërmi gëzimet e mia. Dhe nuk kanë qenë vetjake këto pikëllime, absolutisht jo! Megjithatë, mund ta them me siguri dhe këtë, që nga të gjitha gëzimet e jetës sime prej shkrimtari, kjo mrekulli e vogël e teknikës bashkëkohore, kjo zile telefoni nga Stokholmi në Grasse, më dha mua, si shkrimtar, përmbushjen e plotë. Çmimi letrar, i themeluar nga bashkatdhetari juaj i shquar, Alfred Nobel, është kurorëzimi më i lartë i punës së shkrimtarit! Ambicia është në natyrën e çdo njeriu e çdo autori dhe jam tepër krenar ta marr këtë medalje nga gjyqtarë kaq kompetentë dhe të paanshëm. Por, mos vallë atë nëntë nëntor kam menduar vetëm për veten time? Jo, kjo do të ishte shumë egoiste. Duke e përjetuar nxehtësisht emocionin nga rryma e urimeve dhe telegrameve të para, në qetësi dhe në vetmi e natës, kam menduar për kuptimin e thellë të Akademisë Suedeze. Për herë të parë qysh se është themeluar çmimi *Nobel*, ju ia dhatë një mërgimtar. Po kush jam unë? Një mërgimtar i cili gëzon mikpritjen e Francës dhe për këtë fakt kurdoherë do t'i jem mirënjohës.

Zotërinj të Akademisë, më lejoni, pasi të hiqem

mënjatë, me gjithë librat e mi, t'ju them se sa i mrekullueshëm në vetvete është gjesti juaj. Në botë duhet të ekzistojnë disa sfera të pavarësisë absolute. Pa dyshim, rreth kësaj tavoline ndodhen përfaqësues të çdo mendimi, çdo besimi filozofik dhe religjioz. Por një e vërtetë na bashkon të gjithëve: liria e mendimit dhe e ndërgjegjes, dhe për këtë i detyrohem qytetërimit. Për shkrimtarin, veçanërisht, kjo liri është një aksiomë, një dogmë. Gjesti juaj, zotërinj anëtarë të Akademisë, edhe një herë provoi se dashuria për lirinë është kulti nacional i Suedisë.

Edhe disa fjalë, në mbyllje të këtij fjalimi të shkurtër. Nuk kam pritur ditën e sotme të çmoj lart familjen tuaj mbretërore, vendin tuaj, popullin tuaj, letërsinë tuaj. Dashuria për artet dhe letërsinë ka qenë një traditë e hershme e familjes mbretërore suedeze, ashtu si edhe për të gjithë kombin tuaj fisnik. E themeluar nga një luftëtar i lavdishëm, dinastia suedeze është një nga më të lavdishmet në botë. Madhëria e Tij, mbreti, ky monark kalorësiak i një populli kalorësiak, do t'i lejojë, unë e di, një të huaji, një shkrimtar të lirë, i nderuar nga Akademia Suedeze, që t'i shprehë atij ndjenjat më të thella e të përzemërta të nderimit."

Përktheu nga rusishtja
Bujar Hudhri

AJKUNA DAKLI

çizme lëkure në kohë lufte



OnufriTregime